

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7762 E hënë 14 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga BERAT BUZHALA



Mbrëmja e së premtes është e varfër në televizionet e Kosovës, që të mos them edhe e shtuna dhe e diela, prandaj rëndom, kur jam në shtëpi, kur nuk ...
Vijon në faqen 20

Pse Rama i urren Lubonjën e Bushatin më shumë se neve të tjerëve?

Opinion i Ditës

Nga RONI TELEGRAFI



Perceptimi se asgjë nuk mund të përmirësohet pa u larguar politikanët dhe gjyqtarët e korruptuar ka zënë thellë rrënjë në opinionin publik. Padyshim ...
Vijon në faqen 21

Trekëndëshi i së keqes, si mund të prishet



Antikrimi/ Reportazhi i medias britanike

"Guardian": Mafia shqiptare, mbretërit e kokainës morën në dorë trafikun në Angli

"Lidhjet me 'Ndranghetan' italiane. Serioziteti i tyre uli çmimin dhe rriti cilësinë e drogës"

"Ata janë të sofistikuar, të zgjuar dhe gjithmonë shpërndajnë nga portet e Evropës në rrugët e Londrës, një rrjet kriminal është tashmë në krye të tregut prej 5 bilionë paundësh në Mbretërinë e Bashkuar. Diçka kishte nisur një natë më parë dhe djemtë në qoshe ishin të etur për të dhënë kështilla ...
Në faqen 4

PERFITOJNE PERSONAT QE U KA NISUR PENSIONI PARA 31 DHJETORIT 2014

PENSIONISTET, KATEGORITE QE PERFITOJNE KOMPENSIM

Vendimi i qeverisë, sa lekë marrin personat me të ardhura familjare minimale. Instituti i Sigurimeve: Pensionet e fshatit, llogaritja deri në 690 lekë



(Në foto) Pensionistë (foto ilustruese)

Në faqen 6-7

REAGIMI MASIV

Qindra studentë "ngujohen" tek Ekonomiku: Na plotësoni kërkesat

Në faqen 9

VENDIMI

Certifikata e Cakajt, drejtori i DSIK-së i kalon kompetencat vartësit

Në faqen 2

"LIFE PAGES"

Mjekja Albana Duni: Si mund të kurohen çrregullimet e aparatit tretës

Suplement

KOMITETI SHTETEROR

Krijohet struktura për negociatat me BE, pa përfaqësues të partive opozitare

Në faqen 3

RREFIMI I URAN BUTKES



Plagosja e Sali Butkës më 1914, kur mbronte Korçën nga mësymja greke
Në faqen 18-19

Arsimi i lartë/ Vijon sesioni i trajnimeve në bashkëpunim me "McCain Institute"

"Luarasi", leksion për leadershipin në tranzicion

Arben Malaj: Ky institucion, një nga investimet më të mira në arsim

NGA VOLTIZA DURO

Në kuadër të bashkëpunimit me 'McCain Institute', Arizona State University, studentët e universitetit "Luarasi" kanë pasur mundësinë të ndjekin leksionin e radhës mbi leadershipin. Prof. dr. Arben Malaj



i është rikthyer edhe njëherë auditorit të këtij institucioni për të diskutuar mbi temën "Leadershipi shqiptar gjatë tranzicionit. Rriteni edhe kur humbni!". Studentët janë njohur me tiparet dalluese të një lideri dhe domosdoshmërinë e modernizimit të ...
Në faqen 8

ZGJDHJET VENDORE KANDIDATET

Kreu i DSIK, Dorian Tola ka deleguar të drejtën e firmës për certifikatat te Mark Ndreca

Certifikata e Cakajt, drejtori i DSIK i kalon kompetencat te vartësi

E drejta e firmës i kalon drejtorit të Drejtorisë së Vetingut

Ditët e fundit Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) që vepron në varësi të kryeministrit Edi Rama, është vënë në qendër të akuzave të Presidentit të Republikës, Ilir Meta si dhe të opozitës. Shkak është bërë pikërisht dhënia e certifikatës së sigurisë për Gent Cakajt, i propozuar nga kryeministri Rama për të qenë ministër i Jashtëm. Madje, Presidencia dhe opozita duke pretenduar se DSIK ka shkelur ligjin duke bërë një verifikim të figurës së Cakajt brenda 24 orëve, kanë kërkuar edhe nisjen e një hetimi parlamentar, për të parë nëse janë zbatuar hapat ligjorë në këtë rast ose jo. Por në kulmin e këtij debati, drejtori i përgjithshëm i DSIK-së, Dorian Tola ka vendosur që të heqë dorë nga kompetenca dhe e drejta për të firmosur certifikatat e sigurisë. Njëpërmjet një urdhri të publikuar në Fletoren Zyrtare, Dorian Tola i kalon një prej vartësve të tij një sërë kompetencash, përfshi edhe atë për lëshimin e certifikatës së sigurisë. Në konkretisht, njëpërmjet këtij urdhri, Tola bën delegimin te Mark Ndreca me detyrë, drejtori i Drejtorisë së Vetingut dhe Sigurimit Industrial, të kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve që aplikojnë për CSP dhe operatorëve ekonomikë që aplikojnë për CSI. Njëpërmjet këtij urdhri Dorian Tola autorizon Mark Ndreca të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë, si dhe të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht drejtuar autoriteteve kontraktore. Po ashtu, njëpërmjet këtij urdhri Ndreca merr kompetencën që të firmosë shkresat për përditësimin e rekordeve të operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht, drejtuar



Drejtori i përgjithshëm i DSIK-së, Dorian Tola

URDHRI
Dorian Tola autorizon Mark Ndreca të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë, si dhe të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht, drejtuar autoriteteve kontraktore.

Përplasjet qeveri-Presidentë, Bushati anulon axhendën jashtë shtetit

Kriza institucionale mes Presidentës dhe qeverisë, me në qendër ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme ka sjellë edhe pasojat e para në funksionimin e diplomacisë shqiptare në raport me partinerët ndërkombëtarë. Pas anulimit të vizitës në Bruksel pak ditë më parë, ku ishte programuar edhe një takim me kreun e politikës së Jashtëm të BE-së, Federica Mogherini, ministri i Jashtëm në ikje, Dimitri Bushati ka anuluar një tjetër vizitë të rëndësishme, kësaj here në Gjermani. "Top Channel" raportoi dje se ministri i Jashtëm, Dimitri Bushati, e ka anuluar vizitën e tij në Gjermani, të programuar për javën e ardhshme. Bushati duhej të

takonte homologun e tij në Berlin, ku të martën, më 15 janar do të pritej në vizitë zyrtare nga ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Mass. Zhvillimet e fundit kanë detyruar Dimitri Bushatin të anulojë axhendën e jashtme, pjesë e së cilës ishin edhe dy takime në Bruksel më 10 janar, gjithashtu të anuluar: ai me shefen e politikës së jashtme të Bashkimit Europian, Federica Mogherini, si dhe takimi me eurokomisionerin për Zgjerimin, Johannes Hahn, asnjëri prej të cilëve nuk u zhvillua. Dimitri Bushati gjendet në kushtet ku kryeministri ka zgjedhur ta zëvendësojë atë, ndërsa presidenti refuzon të dekretojë largimin e tij. Burime nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtëme bënë me dije se pavarë-

sisht kësaj situatë dhe anulimit të axhendës së jashtme, mbetet të konfirmuara dy takime të tjera të ministrit Bushati me homologët e tij në Tiranë. Bëhet fjalë për vizitat në Shqipëri të ministrit italian, Enzo Moavero Milanesi, programuar për të mërkurën më 16 janar, si dhe atë të ministrit të Jashtëm holandez, Stef Blok, në axhendë të enjten. Burimet shpjegojnë se për të ruajtur seriozitetin e shtetit, Dimitri Bushati nuk ka kërkuar anulimin e këtyre dy vizitave, për sa kohë ata janë ftuar nga autoritetet shqiptare, si dhe nga ana tjetër të dy ministrat e Jashtëm kanë konfirmuar vullnetin për t'u takuar me ministrin Bushati, pavarësisht zhvillimeve të fundit.

autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, si dhe të firmosë shkresat përcjellëse për dërgimin e CSP tek institucionet shtetërore. Në bazë të urdhrorit të nxjerrë, ky delegim kompetencash do të zgjasë për gjatë gjithë vitit 2019, ndërsa vetë Ndreca përcaktohet

se nuk mund t'i delegojë këto kompetenca te tjerët. Nuk dihet nëse ky urdhër ka të bëjë me debatin që është krijuar ditët e fundit apo jo, megjithëse ai ka dalë pikërisht në ditën kur Presidenti Meta publikoi kërkesën drejtuar Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor për vep-

rimtarinë e DSIK-së dhe procedurat e ndjekura prej saj në rastin e pajisjes me certifikatë sigurie të Gent Cakajt. Në një deklaratë për mediat, DSIK sqaroi se pajisja me certifikatën e sigurimit të personelit për Gent Cakajn është kryer në përputhje të plotë me kërkesat e



Asambleja e PS-së

Ballë: Opozita po bllokot votën e shqiptarëve në diasporë

Partia Socialiste ka mbledhur në Athinë asamblenë e degëve të saj në të gjithë Greqinë. I pranishëm në këtë takim ishte edhe kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla; kryetarja e PS-së së Tiranës, Blerina Gjylahmeti dhe ministri i ri i Bujqësisë dhe sekretari elektoral, Bledi Çuçi. Sekretari i Përgjithshëm, Taulant Balla, duke folur në lidhje me përgatitjet elektorale u shpreh se PS ka filluar tashmë organizimet për fitimin e zgjedhjeve vendore. Kreu i grupit të PS tregoi ambicien e partisë së majtë për të fituar në të 61 bashkitë, ndërsa akuzoi opozitën për bllokim të reformës zgjedhore. Sipas tij, ndryshimet ligjore që ka paraqitur PS garantojnë votën e shqiptarëve që janë jashtë Shqipërisë, ndërsa theksoi se opozita nuk pranon t'i votojë ato. "Kemi filluar tashmë organizimin elektoral për zgjedhjet e 30 qershorit. Jemi e vetmja parti në Shqipëri që garon për të fituar në 61 bashkitë. Asambleja ka përgatitur një strukturë organizimi të re. Për fat të keq opozita ka bllokuar Reformën Zgjedhore, votën e shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit. Do bëjmë gjithçka që në zgjedhjet 2021 të votoji edhe ju këtu dhe kudo në botë", - tha Balla në asamble.

legjislatonit në fuqi. "Verifikimi i sigurisë për z. Gent Cakaj është kryer i plotë, me përparësi dhe në përputhje me detyrimet ligjore. DSIK administron përgjigjet zyrtare të Autoriteteve Verifikuese brenda vendit; SHISH, SHÇBA, si dhe të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), si i vetmi Autoritet Verifikues i Republikës Kosovës, (pasi z. Cakaj mban edhe shtetësinë e Kosovës, krahas shtetësisë shqiptare). Referuar përgjigjeve të Autoriteteve Verifikuese ka rezultuar se për z. Gent Cakaj nuk ekziston rrezik i papranueshëm sigurie për pajisjen e tij me CSP, sipas kërkesës së

paraqitur nga MEPJ", - thuhet në deklaratën e DSIK-së për këtë rast. Gjithashtu, ajo shtoi se nga procesi i verifikimit të sigurisë të Gent Cakajt nuk ka rezultuar asnjë rrethanë ligjore, sipas së cilës DSIK ka qenë e detyruar për të kërkuar informacion shtesë, apo për të shtrirë verifikimet e sigurisë në vende të tjera si Hungaria e Belgjika, të cilat gjithsesi janë vendet anëtare të NATO dhe BE. Po ashtu, ky institucion bëri të ditur se procedurat e verifikimit të sigurisë janë ndjekur me angazhim maksimal brenda afateve kohore të parashikuara.



Komiteti Shtetëror për Integrimin do jetë organi më i lartë dhe drejtohet nga Rama

Krijohet struktura për negociatat me BE-në, "përfashtohet" opozita

Në asnjë nga organet e reja nuk ka përfaqësues të minorancës

Shqipëria pret në qershor një vendim pozitiv nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Ndaj, për t'i paraprirë asaj që do vijë pas këtij vendimi, qeveria shqiptare ka miratuar edhe krijimin e një strukture të posaçme shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kjo strukturë ka si qëllim realizimin e procesit të shqyrtimit të përfaqësimit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian, përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian, si dhe negociimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Por, ajo që bie në sy këtë strukturë të re është mungesa e përfaqësimit të opozitës, pavarësisht se bëhet fjalë për një proces që qëndron mbi palët dhe që përbën një interes kombëtar të të gjithë shqiptarëve.

STRUKTURA

Sipas vendimit të qeverisë, struktura zyrtare e negociatave do të përbëhet nga 6 grupe të veçanta pune ose organe, të cilat do të kenë secila detyrat e tyre. Më konkretisht, pjesë e kësaj strukture do të jetë Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian, Delegacioni Shtetëror, Grupi Negociator, Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Sekretariati i Integrimin Evropian dhe grupet ndërinstitucionale të punës. Sa i përket Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian, ai do të jetë organi më i lartë që siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues. Komiteti drejtohet nga kryeministri dhe në të marrin pjesë: kryetari i Delegacionit Shtetëror, kryenegociatori, ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë, sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

STRUKTURA E NEGOCIATAVE

1. Struktura përgjegjëse për negociatat përbëhet nga:

- Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian.
- Delegacioni Shtetëror.
- Grupi negociator.
- Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Sekretariati i Integrimin Evropian.
- Grupet ndërinstitucionale të punës.
- Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.

2. Organizimi, veprimtaria, funksionimi dhe bashkërendimi i punës së strukturave midis njëra-tjetrës dhe më gjerë kryhen me akt të veçantë.

Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian

1. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian krijohet si organi më i lartë që siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull të acquis, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave.

2. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian drejtohet nga kryeministri dhe në të marrin pjesë:

- Kryetari i Delegacionit Shtetëror.
- Kryenegociatori.
- Ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë.
- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

3. Në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian merr pjesë, gjithashtu, ministri që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, si dhe ftohen të marrin pjesë kryetarët e institucioneve të pavarura, sipas tematikës së diskutimit për secilin kapitull të acquis.

4. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian mbështetet nga grupi negociator, siç përcaktohet në kreun V, të këtij vendimi. Procedurat dhe organizimi i punës së Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian vlerëson dhe bashkërendon qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, të paraqitur nga kryenegociatori.



STRUKTURA

Pjesë e kësaj strukture do të jetë Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian, Delegacioni Shtetëror, Grupi Negociator, Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Sekretariati i Integrimin Evropian dhe grupet ndërinstitucionale të punës.

Dita e 71 e protestës: Vetëm të vdekur largohemi nga këtu

Banorët e zonës së "Astirit" në kryeqytet, banesat e të cilëve preken nga projektet i Unazës së Re kanë vijuar edhe mbrëmë protestën e tyre. Në ditën e 71-të të protestës, ata bllokuan sërish për pak momente rrugën, ndërsa kërkuan anulimin e projektit. "Nesër Rama do të futet në hasmëri me mua dhe çdo banor të Unazës së Re, në jemi të përgatitur. Zoti Rama po ta mbajti hajde vetë, mos dërgo ata vëllezërit tanë policë", - u shpreh një prej banorëve. "Vetëm të vdekur do të largohemi nga këtu", u shpreh një tjetër banorë. Protestës iu bashkua edhe deputeti i PD, Klevis Balliu, si dhe ai i LSI-së, Endrit Brahimllari. "Qeveria të hapë veshët, largohuni nga ky projekt ose



në të kundërt do iu pijë e zeza. Nëse do ta provosh me forcë, kanë 100 herë më shumë forcë banorët e 'Astirit' dhe studentët më shumë se ty dhe është ajo forcë e shqiptarëve që do të nxjerrë ty jashtë. Ky kërkim të ndajë shqiptarët në jug dhe veri, demokratë dhe so-

cialistë. Të gjithë bashkë do të përgjigjen për të të rrezuar ty dhe çfarë ke mbrapa. Tani e ke mbushur kupën, hiq fustanin, vish pantallonat dhe përgjigju si burrë i shtetit, ose këta do të vijnë të të marrin zvarrë për të çuar në prokurori të japësh llogari", - tha deputeti Klevis Balliu. Protestës së djeshme iu bashkua edhe Sazan Guri, i cili kishte një thirrje për kreun e qeverisë. "Mos guxo, pasi për çdo veprim do të mbash përgjegjësi deri në fund të jetës tënde, pasi po matesh me gra dhe fëmijë. Kryeministri të sjellë sa më shpejt psikologët. Të vijnë të marrin nën kujdes këta fëmijë të traumatizuar. Edhe gjermani në fund të fundit i lajmëroi në mënyrë juridike çifutët. Qytetarët janë në të drejtën e tyre", tha ai.

zhvillimin e dialogut politik të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian. Ai përbëhet nga: ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit, kryenegociatori, në funksionin e zëvendëskryetarit, këreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian, përfaqësues të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore, në varësi të fushës së përgjegjësisë shtetërore që është ob-

jekt diskutimi me institucionet e Bashkimit Evropian. Pra, edhe në këtë organ të dytë për nga hierarkia mungon përcaktimi i një vendi në mënyrë nominale për opozitën.

GRUPI NEGOCIATOR

Një tjetër organ i rëndësishëm i kësaj strukture është Grupi Negociator, i cili është përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian. Ai përbëhet nga kryenegociatori dhe jo më pak se 7 anëtarë dhe përbërja e tij. Siç edhe shihet edhe në këtë organ, mungon përfaqësimi i partive opozitare, ndonëse deri më tani procesi negociues është kryer me përfaqësim të gjerë, mazhorancë-opozitë. Ndërkohë që organet apo mekanizmat e tjera negociuese të integritimit të Shqipërisë janë të nivelit teknik dhe më shumë kanë të bëjnë me përfaqësimin tonë në BE dhe sekretariatit teknik që përgatit materialet.

Antikrimi/ Reportazhi i medias serioze britanike: Ulën çmimin dhe rritën cilësinë e drogës

"The Guardian"/ Mbretërit e kokainës: Si mafia shqiptare mori në dorë trafikun e drogës në Angli

Ata janë të sofistikuar, të zgjuar dhe gjithmonë shpërndajnë nga portet e Evropës në rrugët e Londrës, një rrjet kriminal është tashmë në krye të tregut prej 5 miliardë paundësh në Mbretërinë e Bashkuar. Dëgjoni kishte nisur një natë më parë dhe djemtë në qoshe ishin të etur për të dhënë kështilla. "Ju nuk duhet të silleni vërdallë këtu për shumë gjatë" u shpreh njëri. Ata po qëndronin pranë "Crispe House", një bllok kullash i ndodhur në pjesën lindore të Londrës, territorit i padiskutueshëm i etiketuarve "Hellbanianz" (Shqiptarët e ferrit). Banda, një ekipazh shqiptar i shpërndarjes së drogës në rrugë, është e njohur lokalisht për dhunën dhe për shfaqjen në media sociale me "Ferrari" e orët "Rolex", të cilat ndihmojnë në rritjen e reputacionit të tyre duke tërhequr e rekrutuar më pas të rinj të tjerë. Po errësohej në momentin që u shfaqën dy burra, kur njëri prej tyre u pyet nëse ishte "Hellbanianz", ai u përgjigj: "Duhet të shkoni". Vëzhguesi u largua nga qendra e ndërtesave "The Gascoigne" dhe iu tha të mos kthehej më. "Hellbanianz" i përkasin lojës së shitjes me pakicë në tregtinë e kokainës. Ata janë tregtarët e rrugës dhe zbatuesit e mafies shqiptare, sindikata kriminale të organizuara shqiptare, për të cilët Agjencia Kombëtare e Krimeve beson se ata po konsolidojnë pushtetin brenda botës së kriminit në Mbretërinë e Bashkuar, në rrugën e tyre për të marrë të gjithë tregun e kokainës prej 5 miliardë paundësh në Britani. Video muzikore të kësaj bande i kujtojnë njerëzve se "Hellbanianz janë gati për dhunë" dhe se ata kanë mjaft persona që i mbështesin e armët zjarri. Megjithatë, burimet e policisë shprehën se "Hellbanianz" zënë shkallën më të ulët në mafien shqiptare. Për të kuptuar rritjen e jashtëzakonshme të shqiptarëve në Britani, mjafton të ngjiteni në katin e 12-të në një rrëzë prej kullave të larta në "Gascoigne estate". Nga atje, horizonti i Londrës, ku shumica e kokainës së tyre do të jetë shfryrë, shtrihet në perëndim. Në krah të kundërt, disa milje përtej Thames, ndodhet porti në të cilin dërgohen ngarkesa të mëdha me kokainë. Këto ngarkesa vijnë nga përtej Atlantikut, prej xhunglave të Amerikës Latine nga ku dhe fillon historia e mafies shqiptare. Mënyra si shqiptarët ia dolën të pushtonin tregun e kokainës në Britaninë e Madhe është një leksion në fushën e kriminalitetit, përmes të bërit miq mafië më të rrezikshme në

botë dhe kërcënimit absolut të dhunës.

Kjo nisi fillimisht me një model biznesi që ishte një koncept i thjeshtë, por mjaft i guximshëm për të përmbytur rendin ekzistues. Për shumë vite importuesit ndërkombëtarë të kokainës punonin veçmas nga tregtarët me shumicë dhe bandat e tyre. Struktura e çmimeve ndryshonte në varësi të pastërtisë së drogës. Sa më e pastër të ishte droga aq më tepër kush-tonte. Shqiptarët e ndryshuan krejtësisht këtë model. Ata nisën të bashkëpunonin drejtpërdrejtë me kartelet kolumbiane që kontrollojnë prodhimin e kokainës. Dërgesa të mëdha u organizuan menjëherë nga Amerika e Jugut. Ekspertët në Britani zbuluan se Shqiptarët e merrnin kokainën nga shitësit Amerikano-Jugor me 4000-5500 paund kilogramin, në një kohë që rivalët e tyre e merrnin një kilogram me 22.500 paund prej shitësve holandezë. Shqiptarët ulën çmimin e kokainës dhe rritën pastërtinë. Dërgesa masive kokaine nisën të vinin drejt Britanisë së Madhe. Tony Sagers, drejtuesi i departamentit të kërcënimeve të drogës dhe inteligjencës në "Agjencinë Kombëtare të Krimeve", i cili ka shpenzuar 30 vite duke analizuar ritimet e ekonomisë globale të drogave u shpreh:

"Në mënyrë inteligjente ata kanë thënë: Mirë, ne kemi vendosur këtë kufi për të luajtur dhe ne jemi duke i dhënë gjithashtu një copë të mirë të kësaj edhe klientit". Shqiptarët kanë ndikuar thellësisht në prodhimin, përdorimin dhe ekonominë e kokainës. Që nga viti 1990, droga është më e lira që ka qenë ndonjëherë në Britani dhe më e pastra për një dekadë, duke shkaktuar një rekord të vdekjeve. Mbretëria e Bashkuar ka numrin më të lartë të përdoruesve të drogës në Europë. Rivalët e bandave shqiptare si "Hellbanianz" hasën tepër vështirësi për shkak se kishin një produkt më inferior me një çmim më të lartë. Ata u detyruan të blinin drogë prej mafias shqiptare. Sagers u shpreh: "Ata kanë treguar se nuk duhet të jeni lakmitar për të dominuar



tregjet e drogës. Ata shkuan në rrugën e çmimeve të qëndrueshme duke pasur dhe një cilësi të mirë të produktit". Për të pasur edhe më tepër sukses, shqiptarët duhet të kontrollojnë portet e europës. Për ta bërë këtë duhet të bashkëpunonin me "Ndrangheta", mafia italiane më e fuqishme dhe e globalizuar, e cila kontrollon tregtinë e kokainës në Europë. Ka dëshmi se shqiptarët kanë formuar aleancën më të fortë me "Ndrangheta". Sipas disa burimeve, mafia italiane i konsideron shqiptarët si të barabartë. Sagers u shpreh: "Ka një lidhje të fortë tashmë mes mafies italiane dhe asaj shqiptare. Shqiptarët po punojnë me ta, jo në konkurrencë ndaj tyre. Plus historikisht italianët kanë kontakte të mira në Amerikën Latine". Rotterdami i Hollandës është porti më i madh në Europë me 8 milionë kontenerierë, të cilët kalojnë përmes tij çdo vit. Shumë prej tyre arrijnë direkt përmes rrugës "kolumbiane" përpara se të kalojnë në Harwich në Essex ose në Hull. Porti i dytë

më i zënë është ai i Antwerp në Belgjikë, i cili lidhet me portin Thames të Tilburit, 15 milje larg territorit të "Hellbanianz". Në total portet belge dhe holandezë, punësojnë 240.000 punonjës, të cilët sipas inteligjencës policore, punojnë për "Ndrangheta" dhe për mafien shqiptare. Sipas Sagers, kjo i jep ma-

"Në mënyrë inteligjente ata kanë thënë: Mirë, ne kemi vendosur këtë kufi për të luajtur dhe jemi duke i dhënë gjithashtu një copë të mirë të kësaj edhe klientit". Shqiptarët kanë ndikuar thellësisht në prodhimin, përdorimin dhe ekonominë e kokainës.

kontrollohet nga bandat shqiptare, pasi janë bandat kriminale të qytetit që e ruajnë me xhelozë pushtetin e tyre në këtë qytet. Shqiptarët njihen në qarqet kriminale si të sofistikuar, profesional dhe si njerëz që e mbajnë premtimin. Ata arrijnë gjithmonë ta shpërndajnë porosinë. Kjo ka të bëjë shumë me kodin shqiptar të "besës", për të mbajtur premtimin. Sipas Sergit, reputacioni i shqiptarëve duhet parë edhe prej kodit të "Kanunit", të së drejtës për t'u hakmarrë: "Gjaku duhet të paguhet me gjak". "Ti beson më shumë ata që janë të ngjashëm me ju", u shpreh ajo. Ky koncept ka si qëllim që t'i mbajë marrëdhëniet e ngushta dhe t'i ruajë gjërat e brendshme. Më pas brezi i ri nisi të bënte edhe video muzikore e t'i tregonte paratë e fituara sheshit, së bashku me ta erdhën dhe gjenerata e "Hellbanianz". "Hellbanianz" mbledhen rreth orës 9 çdo ditë në një vend pranë lokalit të natës "Kings Lounge". "Ata janë të njëjtat fytyra që bëjnë të njëjtin gjë", u shpreh njëri. Disa mund t'i njihin fytyrat e tyre prej "YouTube", ku "Hellbanianz" shfaqen me armë, femra të zhveshura e makina luksoze për të joshur të rinj të tjerë që t'i bashkohen.

fies shqiptare kontroll dhe akses të kokainës në porte.

Një burim i NCA-së tregoi se Belgjika dhe Holanda janë pikat kyçe të konsolidimit dhe trafikimit të mallrave të paligjshëm dhe se grupet shqiptare po zgjerojnë ndikimin e tyre në këto vende. Anna Sergi, lektore në fushën e kriminologjisë në Universitetin e Essex, e cila është specialiste e lidhjeve të mafies, ka konfirmuar bashkimin e forcave të grupeve kriminale të Italisë së Jugut me ato shqiptare. "Kurdoherë që 'Ndrangheta' dërgon mallra, ata bashkëveprojnë me shqiptarët", u shpreh ajo.

Pika më e vështirë për transportimin e drogës nga kontrabandistët është pjesa e hyrjes në port.

"Ndrangheta" u kanë besuar pikërisht këtë pjesë shqiptarëve. "Ju keni nevojë për njerëzit më të aftë për ta nxjerrë drogën nga porti. Nëse jeni të zotë në lëvizjen e gjërave, atëherë qëndroni përpara konkurrentëve tuaj, dhe shqiptarët janë të mirë për këtë" u shpreh Sergi. Megjithatë, edhe shqiptarët që qëndrojnë në hallkat më të larta të kësaj industrie janë kapur ndonjëherë. 30-vjeçari Klodjan Copja, i cili drejtoi një sindikatë importesh të kokainës me vlerë 60 milionë paund u burgos në vitin 2017, pasi korrierët e tij u kapën duke marrë kamionë të ngarkuar me drogë që kishin mbërritur në Kent. Një tjetër aspekt që i dallon bandat shqiptare është se ata nuk krijojnë konflikte me bandat e tjera, por dinë të zhvillojnë marrëdhëniet mes tyre. Liverpool është i vetmi qytet në Angli që nuk

Sagers u shpreh: "Tregu i shitjes me pakicë është mënyra për t'u pasuruar shpejtë. Nëse ata blejnë disa kg për pak mijëra dollarë, imagjinoj se sa para kthehen tek këta të rinj teka shesin 1 gramë kokainë për 40 paund". Para se llogaria e tyre e tyre e "Instagram"-it të mbyllej në nëntor, "Hellbanianz" kishin 115.000 ndjekës në "Instagram". Videoja "Hood Life", në të cilën tregohet një pjesë e pasurisë së tyre është klikuar 7.5 milionë herë. Ata kërcënojnë rivalin shqiptar OTR. Në videon e fundit të tyre të postuar në tetor të vitit 2018, thuhet se ata janë gati për luftë. Personat me shtëpisë shqiptare janë të tretët të renditur sa i takon personave me shtësi të huaj në burgjet britanike. Rekrutimi i adoleshentëve dhe të rinjve në bandën "Hellbanianz", e cila vazhdon të kryejë aktivitetin e saj të paligjshëm në Britani, nuk ka qenë asnjëherë më i thjeshtë se tani.

Operatorët e biznesit ankohen: Ka hapësira për një aferë korruptive

"Unaza", pas fitimit zbulohet një tjetër kriter diskriminues në tender

"News 24" zbardh kërkesën e çuditshme nga ARRSH

Zbulohet një tjetër kriter diskriminues për tenderin e Unazës së Madhe. Dy ditë pas publikimit të kriterit absurd për vinçin 450 tonë, "News 24" zbulon një tjetër kërkesë të çuditshme nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Bëhet fjalë për shkallën e licencës që ARRSH u kërkon operatorëve në garë. Në një nga pikat përcaktohet që firma që do marrë pjesë në tender të ketë kryer punime me impiante dhe linja telefonike, por të jetë të licencës F. Kompania e cila e disponon këtë licencë presupozohet të ketë kryer punime me vlerën mbi 4 mld lekë. Ky kriter e bën të detyrueshëm që kompania duhet të ketë përvojë të jashtëzakonshme që ka të bëjë me shtrimin e kabllave, por jo për ndërtimin e rrugëve. Lidhur me skandalin e Unazës së Madhe, banorët e "Astirit", të cilët preken nga projekti prej më shumë se dy muajsh vijojnë protestat të pandërprera. Pas publikimit nga "News 24" të skandalit për vinçin 450 tonë, kryetari i opozitës, Lulzim Basha kërkoi anulimin e tenderit dhe i cilësoi kërkesa qesharake kriteret e vendosura. Data 14 janar është afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve nga operatorët, të cilët do të marrin pjesë në garë. Pritet që këtë të hënë në orën 10 të bëhet edhe hapja e zarfeve me oferta për të parë se cilat kompani janë në garë.

KRITERI I VINÇIT

Pas dështimit të kontratës mes bashkimit të kompanive "Biba X" dhe "DH Albania" për shkallë të skandalit të falsifikimit të dokumenteve nga ana e firmës mëmë të "DH Albania", "Dunwell Haberman", Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rihapur në 13 dhjetor garën për të njëjtin segment të Unazës së Madhe. Në shpalljen e parë njëjësia e prokurimit publik kishte vendosur kriteret ligjore që ishin haptazi në shkelje të ligjit. Por, ajo që bie në sy edhe në rihapjen e garës së dytë, kriteret e vendosura nga prokurimet duket se përcaktojnë që në fillim operatorin fitues dhe lënë hapësirë të rëndësishme për afera korruptive. "News 24" ka zbuluar dokumentin ku shihet se një nga këto kriteret është kërkesa për kapacitete e mjetëve dhe makinerive që operatorët duhet të disponojnë për të marrë pjesë në këtë procedurë. Lidhur me këtë kërkesë rezultoi se makineritë e kërkuara nuk janë në raport me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen. Në pikën 13, për mjetet e punës kërkohet një autovinc me kapacitet mbi 450 tonë. Por, sipas subjekteve që kërkojnë të marrin pjesë në garë, në preventivin e punimeve të zëri i punës thuhet se nga ana teknike për të tërhequr trarë me gjatësi 34

VINÇI
Pas dështimit të kontratës mes bashkimit të kompanive "Biba X" dhe "DH Albania" për shkallë të skandalit të falsifikimit të dokumenteve nga ana e firmës mëmë të "DH Albania", "Dunwell Haberman", Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rihapur në 13 dhjetor garën për të njëjtin segment të Unazës së Madhe. Në shpalljen e parë njëjësia e prokurimit publik kishte vendosur kriteret ligjore që ishin haptazi në shkelje të ligjit.



FIRMA FANTAZME

Kompania amerikane "Dunwell Haberman" nuk ka fituar vetëm garën për ndërtimin e një pjese të Unazës së Re, për 18 milionë euro pa TVSH, por më 31 tetor 2018 është shpallur fituese edhe e një tenderi tjetër, për ndërtimin e një pjese të linjës 220 kv Burrel-Peshkopi, për një vlerë prej afro 11.7 milionë eurosh.

metra linear që do të përdoren për projektin do të mjaftonte një autovinc me një kapacitet deri në 210 tonë. Këtu lindin edhe dyshimet e operatorëve për një garë sipas tyre jo transparente. Burime nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor thonë për "News 24" se në vendin tonë një mjet i tonazhit me kapacitet 450 tonë nuk gjendet. Sipas potës njëjtave burime, mjeti më i rëndë që ka hyrë në doganat shqiptare është vetëm 10 tonë, por që nuk dihet kapaciteti mbajtës i tij, pasi dogana regjistron vetëm peshën e mjetit dhe jo kapacitetin. Ky kriter thotë operatorët jo vetëm vështirëson pjesëmarrjen në garë, por duket që në fillim se përcaktim dhe fituesin e garës. Kërkesa e prokurimeve për një mjet me kapacitet 450 tonë duket absurde, pasi sipas ekspertëve, tërheqja e trarëve prej 34 metra linearë që do të përdoren për lotin e parë të Unazës së Madhe mund të realizohet edhe me një vinç me një kapacitet maksimumi deri në 210 tonë. Atëherë lindin pyetjet se cila është arsyeja e kërkesës për vinça të tonazhit më të rëndë sesa nevojja për realizimin e veprave të artit në lotin e parë të Unazës së Madhe, nga palati me shigjeta deri tek rreth-rrrotullimi i sheshit "Shqiponja"? Pse njëjësia e prokurimit vendos kriteret diskriminuese, të cilat dëmtojnë konkurrencën dhe pengojnë operatorët ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në garë?

Maskat dhunuan Elton Kelmendin, në fillim u morën telefonat

Grabitja e biznesmenit në Durrës, fqinji: Erdhi i gjakosur, kërkoi ndihmë

Një natë pas ngjarjes ku familja e një biznesmeni u dhunua dhe u grabit nga tre persona të armatosur e maskuar në banesën e tyre, në të gjithë lagjen numër 14 në Shkozet dhe jo vetëm, paniku është i madh te banorët. "News 24" e "Balkanweb" ka qenë dje në lagjen ku banon Elton Kelmendi dhe familja e tij. "Ata të tronditur dhe ne të tronditur më shumë. S'më ka zënë gjumi gjithë natën, imagjinoja ata", thotë një banorë e lagjes për gazetaren Klodjana Haxhiaj. Vetë biznesmeni Kelmendi jashtë kamerës shprehet se kanë shpëtuar mirë pas dhunës së ushtruar nga tre personat e maskuar që i grabitën shumën e parave. Ai tha se ka 12 vjet që merret me biznes, me transport ndërkombëtar me kami-



on. Iu kanë rrëmbyer fillimisht telefonat që të mos komunikoni me askënd. Pasi janë larguar tre personat e maskuar të pidentifikuar ende nga policia, kanë qenë fqinjët e tyre që iu kanë dhënë ndihmën e parë dhe kanë lajmëruar po-

licinë. "Erdhën duke thirrur tek porta. O Xhevo o Xhevo hape derën", dola me vrap i thashë çfarë ka ndodhur. Më tha kanë ardhur hajdutët, më kanë rrëmbyer djalin. Vetë ishte i gjakosur, e kishin goditur dhe kërkonte telefonin për

të njoftuar policinë. E njoftuan pastaj policinë me telefonin tonë, sepse ata s'i kishin telefonat dhe pastaj erdhën policia e të tjerët", tha një fqinj. Në fytyrën e tij dukeshin qartë edhe shenjat e dhunës së mbrëmshme. Kelmendi tha se mbrëmjen e shkuar ka qenë në shtëpi me bashkëshorten dhe djalin e mitur 7-vjeçar. Sipas dëshmisë së dhënë në polici, biznesmeni se bashku me djalin 7 vjeçar kanë qenë duke hyrë në portën e banesës së tyre në momentin që u sulmuan nga tre personat e maskuar. Ata kanë lidhur dhe kanë torturuar vetë biznesmenin dhe bashkëshorten e tij, ndërsa djalin e kanë marrë peng për disa metra në këtë zonë dhe më pas e kanë lënë të lirë.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbartimorë L.D.C

"Trulli + ndertese" me nr. pasurise 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3866, me siperfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.107.280 Leka.

Data e shpalljes: 20.12.2018
Data e zhvillimit: 15.01.2019 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartimorë L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shoqeria permbartimorë JUSTITIA

Shoqeria permbartimorë JUSTITIA shpalli ankandin, faza e treta, per shitjen e pasurise se paaftajshme, per te cilat ka vene hipotekën NBG Bank/ABI BANK, me kello te dhena:

Liqi njesi me sipo, 189 m2 me pasurise 51188nd-1, zk.8350 vol 28 fq146 RR.PM.Yezari TIRANE ne pronesi te z.Arjan Rahmi BAHOLL. Çmimi me te cilin fillon shitja ne ankand eshte 161784 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e tetëdhjetë e katër) € EUR.

Liqi apartamenti sip.132m2 zk.8350 nr.pas.51188nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANE ne pronesi te z.Arjan Rahmi BAHOLL.

Çmimi me te cilin fillon shitja ne ankand eshte 66.528 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pestëdhjetë e tetë) € EUR. Secili ofertues që do të marrë pjesë në ankand duhet të dispozitojë si garancë shumën prej 10 % të çmimit fillestar, në logonin e Shoqërisë Permbartimorë Justitia që është grana Bankës "PKT Bank" sh.a. me numër IBAN AL3820511027444195CLPRCLALLA.

Ankandi zhvillohet ne datën 12.02.2019, ne portulokun e orarit zyrtar, ora 16:30 ne zyrën e permbartimorës gjyqesore, me adrese: Bulvardi Bajram Curri, Pall. 21, Str. 3, Ap. 16, Tirane, Shqipëri.

web: www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

PENSIONET KOMPENSIMET

Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Pensionet e fshatit, llogaritja deri në 690 lekë

Kompensim deri në 760 lekë për pensionistët, kategoritë përfituese

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet plotësuar

Voltiza Duro

Disa kategori specifike qytetarësh në vendin tonë mund të përfitojnë disa kompensime që merren për arsye të paracaktuara në ligj si dhe pensione të veçanta. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot procedurën, kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë individët e interesuar për të marrë këtë pagesë. Masa e kësaj të fundit do të përllogaritet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përkatesisht individët që plotësojnë kushtet mund të përfitojnë kompensime të llojeve të ndryshme, si ai i shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike e lëndëve djegëse, kompensimi i përfituar nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajurit apo gazit të lëngshëm, si dhe kompensim i të ardhurave mujore të pensionistëve. Por, këto kompensime mund të përfitohen edhe në rastet kur individët janë në ngarkim të pensionistëve apo kategorizohen si shtesa në nevojë. Gjithashtu, ata mund të marrin pensionin e posaçëm shtetëror, atë për merita të veçanta, pensionin e dhënë për invalidët e luftës e shpërblimin për veteranët.

KOMPENSIMI DERI NË 190 LEKË

Kompensimi e të ardhurave mujore të pensioneve të qytetit deri në masën prej 190 lekësh e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit; të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet.

KOMPENSIMI DERI NË 200 LEKË

Këtë lloj kompensimi mbi të ardhurat mujore të pensioneve të qytetit në masën deri në 200 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet.



200

LEKE KOMPENSIM

Këtë lloj kompensimi mbi të ardhurat mujore të pensioneve të qytetit në masën deri në 200 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe pensionet e pjesshme familjare të qytetit. Gjithashtu, këtë përfitim e marrin të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare të qytetit si dhe të gjitha pensionet e pleqërisë dhe familjare të qytetit, pasi t'u jenë llogaritur të gjitha kompensimet.

500

LEKE KOMPENSIM

Në bazë të ligjit "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", këtë lloj kompensimi deri në 500 lekë e përfitojnë të gjitha pensionet e pleqërisë, të plotë, të pjesshëm, të reduktuar dhe pensionet familjare të plota e të pjesshme të qytetit.

TË ENERGJISË

ISSH bën me dije se kompensimi e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse në masën 350 dhe 700 lekë e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare të qytetit dhe në masën 200 lekë pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, kur përfituesit banojnë në fshat. Pensionistët e fshatit, kur banojnë në qytet përfitojnë 350 lekë. Për të përfituar 350 lekë apo 200 lekë kompensim, kategoritë e sipërpërmendura duhet të dorëzojnë një deklaratë personale dhe një fotokopje të kontratës të energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Ndërsa, për të përfituar 700 lekë kompensim duhet dorëzuar gjithashtu edhe një certifikatë familjare, kur

KOMPENSIMI DERI NË 760 LEKË

ISSH thekson se këtë lloj kompensimi e përfitojnë të gjitha pensionet e pleqërisë, të plota, të pjesshme, të reduktuara, pensionet e invaliditetit të plotë, të reduktuar, të pjesshëm dhe pensionet familjare të plota, të pjesshme të qytetit.

KOMPENSIMI NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT

KOMPENSIM

ISSH bën me dije se kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse në masën 350 dhe 700 lekë e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare të qytetit dhe në masën 200 lekë pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare, kur përfituesit banojnë në fshat.



Pensionet e fshatit

Kush mund të marrë deri në 690 lekë kompensim, llogaritja

Në buxhetin e shtetit parashikohet kompensimi deri në 690 lekë edhe për të ardhurat mujore të pensioneve të fshatit për të gjithë ata që marrin pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar fshati. Përfitues nga ky kompensim mund të jenë të gjithë ata që marrin pensione të pleqërisë të plota dhe të pjesshme, ata që përfitojnë pension invaliditeti të plotë, të reduktuar apo të pjesshëm si dhe ata që marrin pension familjar të plotë ose të pjesshëm. "Përfitohet: a) Deri në 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e pjesshme të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që përfitojnë një masë pensioni më të vogël se pensioni bazë. Kjo llogaritet si raport i produktit të shumzimit të pensionit të caktuar me 690 lekë dhe prodhimi që del pjesëtohet me pensionin bazë të miratuar; b) 690 lekë në muaj, të gjitha pensionet e plota minimale të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare; c) Deri në 690 lekë në muaj, për të gjitha pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, që kanë kufirin deri tek shuma e pensionit të plotë bazë minimal plus 690 lekë dhe nga kjo shumë zbrisim pensionin e caktuar brenda këtij kufiri; d) Kjo e ardhur është pjesë përbërëse e pensionit dhe përfitohet së bashku me pensionin", - thekson ISSH. Ndërkohë, shpërblimi i luftës apo i njohur si shpërblimi veterani është një shtesë që u jepet veteranëve dhe invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar. Këtë lloj shpërblimi kanë të drejtë ta përfitojnë të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që luftuan kundër pushtuesve nazifashistë nga 7 prilli i vitit 1939 deri në ditën e çlirimit të Shqipërisë; luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të ushtrisë, që luftuan jashtë kufijve të atdheut deri më 09.05.1945. Por, këtë pagesë mund ta marrin edhe të gjithë ata persona që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet, në prapavijë të armikut e në zona të çliruara; kryefamiljarët e atëhershëm të shtëpive të njohura si baza të luftës kundër pushtuesve nazifashistë; të burgosurit dhe të internuar në burgjet dhe kampet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit si dhe shtetasit shqiptarë që kanë marrë pjesë aktive në luftën kundër nazifashistëve në vend të tjera.



Përfitojnë personat me datë fillimi pensioni deri në 31 dhjetor të 2014-ës

Vendimi i qeverisë, kompensimi për të ardhurat mujore minimale

Sa do të marrin individët në ngarkim të të moshuarve, dokumentet

Voltiza Duro

Të gjithë përfutuesit e pensioneve me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit, do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave. Por, kjo me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve të jetë deri në 15 028 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfutuesit e pensioneve. Ndërsa për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, kjo shumë e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit 2.8% nuk duhet të jetë më shumë se 14 528 lekë në muaj.

VENDIMI

Sipas vendimit të qeverisë është parashikuar që kompensimi do të prekë edhe pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", por me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, të arrijë deri në 9 851 lekë në muaj. "Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve"; nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve"; nr.415, datë 27.4.2009, "Për rritjen e pensioneve"; dhe nr.477, datë 30.6.2010, "Për rritjen e pensioneve", do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj", - thuhet në vendimin e qeverisë. Në këtë të fundit theksohet se pas datës 1.7.2018, të ardhurat minimale nga pensionet e plotat qytetit me datë fillimi deri në 31.12.2014, shtuar me kompensimet nuk mund të jenë më të



vogla se 15 528 lekë në muaj, të ardhurat maksimale arrijnë 27 257 lekë në muaj, të ardhurat minimale nga pensionet e plotat të fshatit nuk mund të jenë më të vogla se 10 051 lekë në muaj ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e parakohshme, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 528 lekë në muaj.

PERSONAT NË NGARKIM TË PENSIONISTËVE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se kompensimi për personat në ngarkim të pensionistëve jepet për personat në ngarkim, që ka përfutuesi i pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe familjar. Këtë kompensim e përfitojnë: të gjithë pensionistët që marrin pension, që kanë anëtarë të familjes në ngarkim dhe që janë me banim të përhershëm në qytet, kur kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën e lartë si dhe kur kanë persona të tjerë në ngarkim dhe nuk janë më në marrëdhënie pune", - citon ISSH.

Ndërkaq, masa prej 414 lekësh në muaj jepet për çdo person të familjes në ngarkim në rastet kur fëmijët janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën; si dhe kur nipat, mbesat kur nuk i kanë prindërit, bashkëjetojnë me pensionistin dhe janë në moshën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç kur vazhdojnë shkollën. Ndërkohë, pagesa në masën 207 lekë në muaj jepet kur një nga prindërit është në marrëdhënie pune, ose në pension. ISSH thekson se ky kompensim nuk përfitohet nga pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtaria ekonomike si të punësuar,

KOMPENSIMET MUJORE

Përfutuesit e pensioneve do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë:

■ Deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfutuesit e pensioneve sipas ligjit nr.150/2014.

■ Deri në 14 528 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare.

■ deri në 9 851 (nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

■ Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi nga 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj.

■ Përfutuesit e pensioneve, do të marrin edhe kompensimin "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse", "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm".

punëdhënës, të vetëpunësuar, ose kanë tokë në pronësi. Për të përfutuar nga kjo masë pagese, të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar si fotokopje e letërnjoftimit elektronik, certifikatë familjare, vërtetim nga shkolla, vërtetim nga zyra e tatimeve, taksave dhe nga bashkitë e komunat për mospasje të aktivitetit, vërtetim nga zyra e punës, si punëkërkuar për personat që janë në ngarkim dhe nuk janë në marrëdhënie pune dhe një deklaratë personale.

KOMPENSIMI PREJ 648 LEKËSH

Nga kompensimi 648 lekë në muaj për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj mund të përfitojnë 2 kategori. Respektiv-

isht mund të marrin këtë kompensim kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar, ose të vetëpunësuar në sektorin privat si dhe kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Dokumentacioni që nevojitet për të fituar të drejtën e përfutimit përfshin: deklaratën personale, fotokopjen e letërnjoftimit, fotokopjen e kontratës të energjisë elektrike të lidhur midis OSSH-së dhe personit, fotokopjen e librezës së energjisë, që vërteton se nuk ka detyrime të paguara si dhe një certifikatë familjare.

Pensionet e posaçme shtetërore dhe invalidët e luftës

Pensionet e posaçme shtetërore është një shtesë që jepet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Ky lloj pensioni mund të përfitohet nga të gjithë ata që kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë meritë të veçanta. Por, edhe individët që kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, artëve, ekonomisë dhe politikës si dhe ata që kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist mund të përfitojnë një ku pension. Të interesuarit duhet të dorëzojnë kërkesën, e cila duhet të përmbajë gjeneralitetet, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen etj., dhe duhet të jetë e shoqëruar me dokumentet përkatës si fotokopjen e letërnjoftimit elektronik ose certifikatën e gjendjes civile e vërtetimin nga Sigurimet Shoqërore, nëse merr pension dhe masën e pensionit. Me tej, personat e paaftë për punë duhet të dorëzojnë edhe një vërtetim nga KMCAP-i. Ndërsa, personat me meritë të veçanta duhet të kenë bashkangjitur edhe kopjet e noterizuara të dokumenteve që vërtetojnë këto meritë si titujt, medaljet, urdhrat etj., ndërsa të përndjekurit politikë duhet të dorëzojnë kopjen e noterizuar të statusit të të përndjekurit politik. Por, personat i posaçëm shtetëror nuk mund të jenë më i ulët se dyfishi i pensionit social dhe as më i lartë se katërfishi i tij. Ndërkohë, bëhet me dije se pensioni për meritë të veçanta është pensioni që do të vazhdojë të paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore deri sa përfutuesi të vdesë. Por, sot ky lloj pensioni nuk llogaritet e po vjen drejt mbylljes së tij.

PENSIONI PËR INVALIDË LUFTË

Pensionin për invalidët e luftës është një pension, që u jepet invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar. "Të drejtën e përfutimit nga statusi i invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar e kanë: a) Të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që janë plagosur dhe gjymtuar duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë nga 7 prilli i vitit 1939, deri në çlirimin e Shqipërisë. b) Luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të ushtrisë që janë plagosur dhe gjymtuar duke luftuar jashtë kufijve të atdheut deri më 09.05.1945. c) Të gjithë personat, që janë plagosur dhe gjymtuar, duke zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet, në prapavijë të armikut ose në zonat e çliruar. d) Të burgosurit dhe të internuarit, që janë plagosur dhe gjymtuar në burgjet dhe kampet nazifashiste, brenda dhe jashtë vendit", - bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore.



Pamje nga leksioni i hapur në universitetin "Luarasi"

Vijon sesioni i trajnimeve në bashkëpunim me 'McCain Institute', Arizona University

Në kuadër të bashkëpunimit me 'McCain Institute', Arizona State University, studentët e universitetit "Luarasi" kanë pasur mundësinë të ndjekin leksionin e radhës mbi lidërshtipin. Prof. dr. Arben Malaj i është rikthyer edhe njëherë auditorit të këtij institucioni për të diskutuar mbi temën "Lidërshtipi shqiptar gjatë tranzicionit. Rritni edhe kur humbni!". Studentët janë njohur me tiparet dalluese të një lideri dhe domosdoshmërinë e modernizimit të lidërshtipit në Shqipëri.

"Luarasi", leksion i hapur mbi lidërshtipin shqiptar gjatë periudhës së tranzicionit

Arben Malaj: Ky institucion, një nga investimet më të mira në arsim

BASHKËPUNIMI
Prof. dr. Arben Malaj shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin me 'McCain Institute' e veçanërisht me universitetin "Luarasi". Më tej, ai theksoi se ky investim është jashtëzakonisht i vlefshëm për përgatitjen e studentëve në të ardhmen profesionale. "Është një mundësi për të rishprehur mirënjohjen time për bashkëpunimin me këto dy institucione, veçanërisht me universitetin "Luarasi". Jemi duke diskutuar me studentët lidhur me lidërshtipin gjatë tranzicionit shqiptar, me domosdoshmërinë për ta modernizuar lidërshtipin e vendit tonë, duke e orientuar atë drejt prioriteteve kombëtare, drejt konsensusit, kompromisit. Është një investim jashtëzakonisht i vlefshëm, që universiteti "Luarasi" bën me institutin McCain për të ndihmuar që lidërshtipi i ri shqiptar të ketë një vizion më të qartë", - tha Malaj në fjalën e tij.

AVANTAZHET E "LUARASIT"
Universiteti "Luarasi" vazhdon të ndjekë praktikën bashkëkohore të leksioneve të hapura me ekspertët e profesionistët më të mirë. Prof. dr. Arben Malaj e vlerëson "Luarasin" si një nga investimet më të mira në arsimin shqiptar. Ai thekson se diploma e këtij universiteti është një aset në duart e studentëve që përfundojnë studimet e larta në "Luarasi". "Patjetër që diploma e universitetit "Luarasi" është një aset më vete. "Luarasi" është një nga investimet më kredibile që është bërë në sistemin universitar të vendit tonë, që nga themeluesit e tyre dhe ecuria pozitive vit pas viti.



Prof. dr. Arben Malaj

Mendoj se avantazhi kryesor i universitetit "Luarasi" është baza historike mbi të cilën ai është rritur, stafi akademik, përfshirja reale e studentëve gjatë procesit mësimor për të dalë në jetë si disa individë, që nesër mund të jenë pjesë e lidërshtipit të vendit të tyre, si në pjesën e politikës, si në pjesën e shkencave apo në pjesën e biznesit", - theksoi prof. dr. Arben Malaj.

TRAJNIMI

Disa javë më parë, në kuadër të bashkëpunimit me 'McCain Institute', Arizona State University, universiteti "Luarasi" ka zhvilluar sesionin e radhës së trajnimit "Lidërshtipi i Udhëhequr nga Karakteri". Paul Converse Johnson, trajnues lidërshtipi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë një bashkëbisedimi me studentët diskutoi rreth tipareve dalluese të një lideri për të fituar besimin e komunitetit të tij, siç janë, vlerat, etika dhe integriteti. Ai më tej i njohu të rinjtë me praktikën më të mira të lidërshtipit në Amerikë. Studentët pjesëmarrës në këtë trajnim janë angazhuar vullnetarisht në komunitet me projektet e tyre personale në mbrojtje të kauzave shoqërore.

CERTIFIKIMI

Trajnimi "Lidërshtipi i



Udhëhequr nga Karakteri" filloi në tetor të këtij viti akademik e në përfundim të tij, studentët do të certifikohen nga instituti 'McCain' në SHBA. Ky program ka për qëllim krijimin e një kulture

të re në përgatitjen e liderëve të brezave të ardhshëm, të cilët identifikohen nga karakteri i tyre, angazhimi për të shërbyer në një kauzë më të madhe se vetja, aty ku ka më shumë nevojë. Njëpër një praktikave

TRAJNIMI
Disa javë më parë, në kuadër të bashkëpunimit me 'McCain Institute', Arizona State University, universiteti "Luarasi" ka zhvilluar sesionin e radhës së trajnimit "Lidërshtipi i Udhëhequr nga Karakteri". Paul Converse Johnson, trajnues lidërshtipi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë një bashkëbisedimi me studentët diskutoi rreth tipareve dalluese të një lideri për të fituar besimin e komunitetit të tij, siç janë, vlerat, etika dhe integriteti.

Mbështetur nga nisma "Fondi i Komunitetit", Bashkia e Tiranës po vijon me rikonstruksionin e pallateve në lagje të ndryshme të kryeqytetit. I pranishëm në inspektimin e punimeve të një pallati në njësinë 5, kryebashkiaku Erion Veliaj u bëri thirrje qytetarëve që të zgjedhin administratorët e pallateve për të përfutur nga ky fond. "Filluam para pak muajsh me ato që ishin pallatet e para të 'Arabit' dhe banorët e tjerë e panë se si po dilte në dritë pallati

"Fondi i Komunitetit", vijon rikonstruksioni i pallateve në Tiranë

ngjitur, ndaj filluan edhe ata të marrin nga energjia pozitive e transformimit. Thirrja ime për të gjithë banorët është: Ky është viti kur kemi financuar më shumë projekte komunitare, ndaj i ftoj që fillimisht të zgjedhin administratorin e pallatit të tyre dhe pastaj të aplikojnë. Ky është një pallat, i cili deri dje dukej një katrahurë; sot as kabllot nuk duken më", - tha Veliaj. Ky i fundit theksoi se përmirësimi i infras-



strukturës ka sjellë edhe rritje të vlerës së pronës për qytetarët. "Kemi bërë

shumë punë këto katër vite, por një ndër gjërat për të cilën jam më shumë krenar është që këto katër vite kemi mësuar të jetojmë bashkë. Të gjithë bashkë, për të mirën e përbashkët, për një pallat të përbashkët, një hapësirë të përbashkët, një rrugë, kopsht, shkollë, çerdhe të përbashkët. Kjo formulë funksionon dhe më vjen mirë që vatra e së mirës po përhapet", - u shpreh kryebashkiaku.

PROTESTA E STUDENTËVE VENDIMET

Voltiza Duro

P prej disa ditësh, shumë prej studentëve të uni versiteteve publike në kryeqytet janë ngjuar brenda godinave të fakulteteve të tyre deri në plotësimin e 9 kërkesave që i kanë drejtuar qeverisë. Ata nuk tërhiqen dhe vazhdojnë të qëndrojnë në vendosur, pavarësisht konfrontimeve me policinë, administratorët e fakulteteve dhe presioneve të shumta që kanë marrë këto ditë. Sipas studentëve, deri më tani të rinjtë janë ngjuar brenda Fakultetit Ekonomik, Juridik, Shkencave Sociale, Fakultetit të Shkencave në Universitetin e Tiranës. Kësaj forme proteste i janë bashkuar edhe studentët e Arkitekturës, Mjekësisë, Politeknikut dhe Bujqësorisë. "Jam student në Universitetin Politeknik të Tiranës, dega Mekatronikë, në vitin e tretë. Unë nuk jam një nga koordinatorët e fakulteteve, por kam qenë pjesëmarrës në protestë që ditën e parë të nisjes së saj. Deri tani janë ngjuar studentë në disa fakultete të Tiranës, të Universitetit Bujqësor, të Universitetit të Mjekësisë, Arkitekturës, Shkencave Sociale, Ekonomikut dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës", thotë për "Gazeta Shqiptare", studenti Franc Ribaj. Ky i fundit shton se deri më tani nuk kanë vendosur ende se sa do të zgjasë kjo qëndrues dhe cilat do të jenë hapat e mëtejshëm. "Qëndresa në fakultete nuk e dimë sa do të zgjasë, sepse disa fakultete po e vendosin vetë kohën me anë të koordinatorëve. Ngujimi ka disa të mira, pasi studentët po njihen me njëri-tjetrin, po dalin nga ajo paranoja e partive dhe po fillojnë të organizohen në tërësi. Nga ana tjetër, ka mungesë ushqimesh dhe batanijesh. Do ua dinim shumë për nder në qoftë se qytetarët e Tiranës do të na ndihmonin. Përsa i përket vijueshmërisë, nuk dihet, ende kështu që mentalisht mund të themi akoma 'bojkot të mësimit', - thekson Ribaj për "GSH".


VENDIMI I STUDENTËVE

Mbrëmjen e djeshme, qindra studentë nga universitetet të ndryshme janë mbledhur në godinën e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës dhe kanë vendosur që bojkoti i mësimit të vazhdojë edhe në ditët në vijim. Kanë qenë rreth 200 studentë që fillimisht janë mbledhur në dera e këtij fakulteti dhe i kanë detyruar rojet që të hapin derën për t'u futur në ambientet e godinës për të bërë mbledhje. Rojet e policisë

Bashkohen edhe studentët e Mjekësisë: Jemi këtu deri në plotësimin e kërkesave

Qindra studentë, mbledhje tek Ekonomiku: Ngujim pa afat brenda fakulteteve

Thirrja për ndihmë, Ribaj: Ju lutemi, na sillni batanije dhe ushqime!



Studentët e Mjekësisë ngjuhen në fakultet

Edhe studentët e Fakultetit të Mjekësisë i janë bashkuar ngujimit të qindra studentëve mbrëmjen e djeshme. Në videon e publikuar në faqen "Studentët denoncojnë", të rinjtë shfaqen të ulur në banka me maska dhe uniformat e bardha, duke thirrur në kor: "Studentët e bashkuar kanë për të fituar". Kështu, ata u bashkohen studentëve të Ekonomikut, Inxhinierisë, Juridikut dhe Arkitekturës, të cilët vijojnë ngujimin prej 5 ditësh në fakultetet përkatëse deri në plotësimin e kërkesave të tyre.



Edi Rama

SHPJEGIMET PËR STUDENTËT

Në një kohë që studentët janë ngjuar në ambientet e fakulteteve të tyre, kryeministri i vendit, Edi Rama deklaroi se nga nesër (sot) përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit do të vendosen pranë sekretariateve të universiteteve. "Nga nesër në sekretariatet e universiteteve do të vendosen dy përfaqësues të ministrive të Financave e të Arsimit, për të asistuar studentët që duan shpjegime apo duan të adresojnë probleme specifike, lidhur me zbatimin e VKM-së mbi tarifat e bursat brenda janarit. Me studentët", shkruan Rama në "Twitter".



Politekniku

SHKRESA: JO HYRJE-DALJE

Dhjetëra studentë të Fakultetit të Inxhinierisë e Ndërtimit dhe të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës vijojnë të qëndrojnë të ngjuar brenda godinës së fakultetit. Ndërkohë, Universiteti Politeknik i Tiranës i është drejtuar me një shkresë policisë private që merret me ruajtjen e objektit. "Disa persona janë grumbulluar në katin e parë. Ju lutem të merrni masa për respektimin e kontratës së shërbimit, për të mos lejuar hyrje-daljet e personave të paautorizuar në ambientet e territorit të godinave dhe ambientet e brendshme të tyre", - nënvizohet në shkresë.

Deklarata tek Ekonomiku

"Nëse mendoni se jemi partiakë, në djall shkofshi"

Mesditën e djeshme, studentët e Fakultetit Ekonomik kanë dhënë një deklaratë për mediat nga hekurat e derës së shkollës (policia nuk lejoi hapjen e saj). Ata kanë theksuar se kanë mbështetur të gjithë kolegëve të tjerë, si dhe kanë hedhur posh-

të akuzat se janë partiakë. "Nëse mendoni se jemi partiakë, në djall shkofshi se bashku me ta! Ne nuk kemi pranuar as nuk pranojmë asnjë prej tyre. Kemi menduar se arsimit është zgjidhja më e mirë, por çfarë ndodh në Shqipëri. Ne jemi ende të papërfaqësuar. Pa




karrige, ku dritaret mungojnë e i ftohti të pret. Qëllimi i kësaj proteste nuk ishte rrezimi i një partie, por krijimi i një të ardhmeje brenda vendit tonë e jo duke u larguar nga Shqipëria", - thanë studentët.

private nuk kanë bërë rezistencë si herët e tjerë, duke qenë se numri i studentëve

ishte i madh. Më tej të rinjtë bashkërisht nuk janë tërhequr nga rezistenca e

tyre dhe theksojnë se ngujimi do të vazhdojë pa afat deri në plotësimin e 9 kërkesave

të tyre. "Vendosëm bashkërisht që ngujimi dhe bojkoti i mësimit të vazhdojë pa afat. Kërkesat tona qeveria nuk i ka plotësuar, kështu që u bëjmë thirrje të gjithë studentëve të tjerë të na bashkohen, pasi kjo është kauza jonë, nuk duhet të tërhiqemi. Ne jemi e ardhmja dhe Shqipëria është e gjithë shqiptarëve. Politikanët duhet të jenë në shërbimin tonë dhe jo në marioneta në duart e tyre. Nuk jemi dele. Kërkojmë ndryshim dhe arritëm të zgjonim sërish shpresën te populli, te prindërit tanë që robtohen gjithë ditën për të na shkolluar. Studentët e bashkuar kanë për të fituar", - thotë një tjetër studente për "Gazeta Shqiptare".



Universiteti i Durrësit u bashkohet studentëve të Tiranës

Edhe studentët e universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës do t'u bashkohen shokëve të tyre. Ata njoftojnë se ditën e sotme, në orën 8.30 do të protestojnë te Kampusi Spitalë. "Ftojme të bashkohen të gjithë studentët e universitetit të Durrësit për të drejtat tona, për një arsim më cilësor dhe një të ardhme më të mirë", - theksohet në pankartën e studentëve që bëjnë thirrje.

Trajkoviç: Aleksandar Vuçiç u pajtua me formimin e FSK

Ish-deputetja kosovare: S'kemi frikë nga presidenti serb, ka izoluar pavarësinë tonë



Rada Trajkoviç

RADA TRAJKOVIÇ

"Presidenti serb është pajtuar me formimin e Ushtrisë së Kosovës me kushtin që ajo të jetë vetëm deri në lbër. Ky kusht, siç po shihet, nuk do të respektohet. Aleksandar Vuçiç e ka izoluar pavarësinë e Kosovës, për këtë ai duhet të ndiqet penalisht", tha Trajkoviç.

Radojiçiçi, si të dyshuar për vrasjen e politikanit serb në Kosovë, Oliver Ivanoviç. Ish-deputetja serbe në Kuvendin e Kosovës ka shkuar edhe më larg në akuzat ndaj presidentit serb, duke thënë se Vuçiç është pajtuar me formimin e Ushtrisë së Kosovës. "Presidenti serb është pajtuar me formimin e Ushtrisë së Kosovës, me kushtin që ajo të jetë deri në lbër. Ky kusht, siç po shihet, nuk do të respektohet.

Aleksandar Vuçiç e ka rrumbullakuar pavarësinë e Kosovës. Për këtë ai duhet të ndiqet penalisht", tha Trajkoviç. Thuhet se protesta në Serbi do të ketë edhe më 17 janar, në ditën kur në Beograd do të vijë presidenti rus, Vladimir Putin.

Ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës, Rada Trajkoviç ka folur në protestën e fundit në Beograd kundër presidentit serb, Aleksandar Vuçiç. Trajkoviç ka adresuar kritika të rënda në drejtim të klasës politike serbe në pushtet, veçmas ndaj presidentit Vuçiç. Siç raportojnë mediat serbe, Trajkoviç akuzoi përfaqësuesit politikë të serbëve në Kosovë dhe presidentin Vuçiç, duke thënë se për shkak të tyre ser-

bët po shpërngulen nga Kosova. "Ne nga Kosova nuk kërkojmë shumë, ne kërkojmë që serbët të mos kenë frikë nga serbët dhe se

ne kemi frikë nga Vuçiç në pushtet", tha Trajkoviç. Ajo po ashtu kërkoi nga Vuçiç që të ekstradojë nënkryetarin e Listës Serbe, Milan

Kryeministri grek: E falënderoj kreun e "Grekët e Pavarur" për koalicionin

Dorëheqja e Kammenos, Tsipras emëron ministrin e ri

Largohet Panos Kammenos: ANEL tërhiqet nga qeveria

Pas dorëheqjes së Panos Kammenos, ministri i ri i Mbrojtjes në Greqi do të jetë shefi i Mbrojtjes, admiral Evangelos Apostolakis, raportoi kryeministri Alexis Tsipras. "Për gati 4 vite kam qenë në një bashkëpunim të ndershëm dhe të sinqertë me Panos, por vijnë nga familje të ndryshme politike", tha kryeministri grek pas takimit me kreun e ANEL, Kammenos. "Pas një bisede të pastër me të e falënderoj me gjithë zemër për të gjithë kontributin e dhënë në koalicionin", përfundoi Tsipras. Ministri dhe njëkohësisht lideri i partisë ANEL, Panos Kammenos deklaroi se partia e tij do të tërhiqet nga koalicioni me qeverinë greke, pas takimit me kryeministrin Alexis Tsipras. Pas takimit në rezidencën Maximos, në një deklaratë për shtyp Kammenos tha se pati një bisedë të gjatë me kryeministrin. "Patëm një bashkëpunim që zgjati plot 4 vite në një qeveri për unitet kombëtar. Ne arritëm shumë së bashku. Falënderova kryeministrin. Në çështje kombëtare, bashkëpunimi nuk mund të vazhdojë. ANEL tërhiqet nga qeveria", tha ai. Kujtojmë se ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kammenos dha dorëheqjen këtë të diel, në shenjë proteste për marrëveshjen e arritur me Maqedoninë për çështjen e emrit, duke vënë kështu në rrezik të ardhmen e koalicionit qeverisës disa muaj përpara se vendi të shkojë në zgjedhje kombëtare. Panos Kammenos, partia "Grekët e Pavarur" e të cilit është pjesë e qeverisë së kryeministrit grek, Alexis Tsipras, e kundërshtonte prej kohësh marrëveshjen me Maqedoninë fqinje, të firmosur vitin e shkuar nga qeveritë e dy vendeve. "Çështja e emrit të Maqedonisë nuk më lejon që të mos e sakrifikoj karrierën e ministrit", tha Kammenos pas një takimi që pati me Tsipras,

mëngjesin e djeshëm. Sipas asaj që shkruan "Reuters", ai tha gjithashtu se do të tërhiqte edhe 6 ministra të tjerë të partisë së tij nga qeveria. Impakti që do të ketë dorëheqja e tij në koalicionin qeverisës nuk është ende i qartë. Zgjedhjet parlamentare në Greqi pritet që të mbahen më tetor. Koalicioni i Tsipras ka 153 karriqe, nga 300 të tilla që ndodhen në parlament. 145 prej tyre janë nga partia e tij e majtë Syriza. Kammenos, i



Kryeministri Tsipras dhe Panos Kammenos

cili u fut në koalicion me Tsipras në vitin 2015, nuk e kishte fshehur kurrë armiqësinë e tij për marrëveshjen me Shkupin, që i jep këtij shteti emrin e ri, Republika e Maqedonisë së Veriut. Greqia ka një provincë të quajtur Maqedoni dhe kërkonte prej shumë kohësh që Shkupi të ndryshonte emrin e shtetit, për të hequr atë që Athina e konsideronte si një kërkesë e nënkuptuar ndaj territorit sovran të Greqisë.

Zaev mbron emrin e ri Maqedonia e Veriut, opozita kërkon zgjedhje

Kryeministri maqedonas: Po shkruajmë një realitet të ri, së shpejti do të bëhemi anëtarë të NATO-s

fikimin e shpejtë të marrëveshjes edhe nga pala greke. "Unë besoj fuqishëm se shteti mik i yni, Greqia, do të ratifikojë Marrëveshjen e Prespës dhe se do të jetë vendi i parë që do të ratifikojë dokumentin për gasjen e Maqedonisë në NATO", u shpreh kryeministri Zaev. Kryeministri Zaev tha se pas votimit të ndryshimeve kushtetuese dhe mbylljes së kontestit 27-vjeçar të emrit, vendin e presin sfida të shumta për ngritjen e standardit të qytetarëve. "Nuk ka më ndalesa, pasi tani është koha për të zgjidhur çështjet e brendshme. Unë pres që të gjithë ministrat dhe drejtues-

it e komunave të jenë më efikasë në punën e tyre. Kemi një qëllim të përbashkët, që bëjmë jetën më të mirë për të gjithë", ka deklaruar Zaev. Opozita nga ana tjetër edhe një herë vendimin e ka quajtur të dëmshëm për vendit, identitetin, gjuhën dhe kulturën maqedonase. Kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski, ka kërkuar zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare. "Zoran Zaev para kohe e riemëroi atdheun duke u bazuar në një marrëveshje, e cila ende nuk ka hyrë në fuqi. Kjo është e turpshme! Zoti Zaev, Maqedonia sot nuk feston. Maqedonia sot është mbuluar në të zeze

se pse ju shitët, shkelët dhe shkatërruar çdo gjë. VMRO-DPMNE-ja do të bëjë gjithçka që është në fuqinë e saj që të ardhmen ta rregullojë këtë padrejtësi", ka deklaruar Mickovski, duke paralajmëruar se të hënën do të paraqesë kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare në të cilat siç tha: "Zaevi do të marrë dënimin e merituar nga populli për vendimin kapitullues". Kryeministri Zaev tha nga ana tjetër se organet e partisë së tij, LSDM do të shqyrtojnë kërkesën e opozitës, edhe pse siç tha: "Mickovski kërkon zgjedhje, por lutet që këtë të mos e pranojmë". Kuvendi i Maqedonisë me 81 vota

"pro" ka miratuar të premten në mbledhje ndryshimin e Kushtetutës për zbatimin e marrëveshjes me Greqinë për zgjidhjen e kontestit 27-vjeçar të emrit. Marrëveshja e arritur mundëson anëtarësimin e saj në NATO me emrin Maqedonia e Veriut si dhe nisjen bisedime për anëtarësim në BE, në qershor të këtij viti. Kontesti mes dy vendeve daton që nga viti 1991, kur Maqedonia kishte shpallur pavarësinë, ndërsa Greqia kishte bllokuar integrimin e saj në NATO dhe BE, me arsyetimin se fëmijë i saj mund të ketë pretendime ndaj territorit të saj verior që, po ashtu, quhet Maqedoni.

Shtrihet përlëshja e "jelekëverdheve" me policinë deri në Strasburg

SHKURT

Aksident në një minierë, 21 të vdekur në Kinë

Të paktën 21 minatorë kanë vdekur pas shembjes së një miniere qymyrguri në veri të Kinës, sipas asaj që shkruajnë mediat shtetërore kineze. Sipas televizionit shtetëror dhe agjencisë së shtypit "Xinhua", aksidenti ka ndodhur dje në Shenmu, në provincën e Shaanxi, pika kryesore e nxjerrjes së qymyrguri në vend. Rreth 66 punëtorë të tjerë të minières arritën të shpëtohen, ka bërë të ditur qeveria në një deklaratë për shtyp. Numri i viktimave për shkak të shpërthimeve dhe shkatërtimeve në minierat kineze është zvogëluar së tepërmi në dhjetë vitet e fundit, por kjo industri mbetet akoma një nga më vdekjeprurëset në botë.

Francë, vala e 9 e protestave sjell kaos në vend

Manifestuesit kërkojnë dorëheqjen e Macron

Ditën e djeshme një grup protestuesish "jelekëverdhe" u filluan teksa dhunonin një gazetar për motive të paqarta, në qytetin verior të Rouenit në Francë. Aktet e dhunës në valën e 9 të protestave u shtrinë në shumë qytete të mëdha. "Harku i Triumfit" u shndërrua sërish në arenë përlëshjesh mes protestuesve dhe policisë. Dhuna nuk mungoi as në Strasburg. Të ashpra ishin edhe përlëshjet në Nantë. Manifestuesit hodhën parulla ku kërkonin dorëheqjen e presidentit Emmanuel Macron, të cilin e shohin si përgjegjës për reformat ekonomike, të cilat sipas tyre ua kanë vështirësuar jetesën. Protestat nuk i ndalën as lëshimet që qeveria franceze u bëri manifestuesve gjatë javëve të fundit, duke u tërhequr nga disa reforma si ajo që rrit çmimin e naftës. Protestuesit nuk tërhoqën dhe nuk pranorjnë të dialogojnë me Presidentin Macron, i cili ka ofruar të takohen drejt-përdrejt me ta. Kujtojmë se përballë akteve të dhunshme që shpërthyen në Francë, kryeministri Édouard Philippe, bëri thirrje për nevojën që ka vendi për ashpërsim të masave për protestat. Shefi i qeverisë



Protestat në Francë



franceze tha se manifestuesit e dhunshëm duhet të dënohen. "Qeveria është pro plotësisht të ligjit. Të miratohet një ligj i ri, që do të sanksiononte ata që nuk respektojnë rregullat dhe marrin pjesë në manifestime të panjohura. Sot është kundravajtje të vish në protestë me fytyrë të mbuluar, nesër duhet të jetë një krim. Në shumë qytete protestat kanë qenë paqësore, por në nuk mund të lejojmë njëherë që vijnë për të thyer e për të djegur", tha Philippe. Kryeministri njoftoi se mbi 80 mijë forca policore do të angazhohen në protestat e ardhshme, më shumë se 5 mijë prej tyre vetëm në Par-

is. Që prej fillimit të protestave nga të ashtuquajturit "jelekë të verdhë", 5600 persona janë shoqëruar në polici për akte dhune, ndërsa janë regjistruar edhe disa viktima në aksidente rrugore si pasojë e bllokimit të rrugëve. Akti i tetë i "jelekëve të verdhë" në Francë, i pari për vitin 2019, u shoqërua nga protesta të dhunshme, përlëshje me forcat e policisë dhe djegie makinash e bizneseve. Ndryshe nga manifestimet e kaluara, fuqia kryesore e protestuesve u përqendrua në brigjet e Senës, ku u dogjën lokale e sende të tjera. Protestuesit lëshuan gurë mbi policinë, që u

kundërpërgjigj me gaz lotsjellës. Më shumë se 100 persona u arrestuan, ndërsa numri total i protestuesve në të gjithë Francën ishte mbi 25 mijë. "Jelekët e verdhë" protestojnë kundër reformave të presidentit Emmanuel Macron, që i cilësojnë të papërbalueshme. Shefi i Elizës bëri lëshime duke rritur pagën minimale dhe hequr disa taksa, por për protestuesit, kjo ishte e pamjaftueshme. Në Francë, rreth 43,000 njerëz mbetën pa punë për shkak të protestave të "xhakëve të verdhë" që filluan më 17 nëntor. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, shumë kompani kanë pësuar dëme

të mëdha materiale për shkak të protestave të vazhdueshme. Dëmet që i janë shkaktuar shtetit vlerësohen të jenë rreth 28 milionë euro. Gjatë protestës, 10 persona vdiqën dhe rreth 1,000 u plagosën, ndërkaq u arrestuan rreth 4.340. Protestat antiqeveritare të "jelekëverdheve" kanë ndikuar më së shumti në rënien e nivelit të rritjes ekonomike si dhe mungesën e sigurisë së bizneseve. Lëvizja e "jelekëverdheve" mban emrin sipas xhakëve të sigurisë, të cilat duhet t'i posedojnë të gjithë shoferët në Francë. Protestat filluan në mesin e nëntorit dhe u nxitën nga një rritje e tarifës për karburante.

Mbyllja e qeverisë në SHBA, më e gjata në histori

Mbyllja e pjesshme e qeverisë amerikane hyri të shtunë në ditën e saj të 22-të, duke u bërë më e gjata në historinë e Shteteve të Bashkuara. Mbyllja u shkaktua nga kërkesa e presidentit Donald Trump për miliardë dollarë për të ndërtaur një mur mes Shteteve të Bashkuara dhe Meksikës, një lëvizje që është refuzuar nga Dhoma e Përfaqësuesve. Presidenti Trump e quajti situatën në kufirin jugor "një pushtim", por shtoi më pas se nuk do të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme për momentin, si mënyrë për të siguruar fonde për murrin dhe për të rihapur qeverinë. Në komentet e tij të fundit mbi përplasjen me demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve lidhur me kërkesën për mbi 5 miliardë dollarë në fonde fillestare për një barrierë të përhershme në kufi, presidenti tha se do të preferonte që Kongresi të votonte dhe të autorizonte fondet. Pjesë të qeverisë amerikane u mbyllën më 22 dhjetor pasi buxheti skadoi, ndërsa zoti Trump dhe Kongresi debatonin lidhur me kërkesën e presidentit për fondet për ndërtimin e murrin. Mbyllja ka goditur afro një të katërtën e qeverisë federale, përfshirë Departamentin e Sigurisë Kombëtare dhe atë të Shtetit. Rreth 800 mijë punonjës të qeverisë nuk po punojnë dhe nuk paguhen dhe ata që po punojnë nuk e marrin rrogën deri kur të rihapet qeveria.

PUTHJA MES NJË HEBREU DHE PALESTINEZI, PROVOKIM APO NDËRGJEGJËSIM?

Puthja mes një hebreu dhe muslimani do të bënte të ulyeshin armët, përpara një dashurie e aftë të anulohet çdo konflikt, edhe atë më të gjatën dhe të pashërueshmin. Për fat të keq bëhet fjalë vetëm për një foto provokuese e propozuar në rrjetet sociale nga fotografi italian Matteo Meniccoçi dhe e bëri virale në rrjet. "Paqe, dashuri dhe provokim", kështu shkruhet bashkangjitur fotos së ndarë në "Instagram". Mateo është një fotograf 30-vjeçar dhe aktivist i LGBT. Gjatë pushimeve për Vitin e Ri në Jerusalemin me të fejuarin, ai ka qenë viktimë e sulmeve homofobe nga ana e disa djemve. Ka marrë shkas nga ky moment ideja e kësaj fotoje të fuqishme për t'i thënë 'mjart' intolerancës dhe konfliktit shumëvjeçar mes palestinezëve dhe hebrejve.



SHBA

Zjarret në Kaliforni, katastrofa më e shtrenjtë e 2018-ës

Zjarret që përfshinë Kaliforninë vitin e kaluar janë katastrofa natyrore më e shtrenjtë në botë në vitin 2018, njoftoi kompania gjermane e sigurimeve "Munich Re". Kompania thotë se zjarri që shpërtheu në Kaliforni më 8 nëntor shkaktoi një dëm prej 16,5 miliardë dollarësh. Nga zjarri humbën jetën mbi 80 persona dhe rreth 14 mijë shtëpi u dogjën. Një pjesë e dëmit material, prej 12,5 miliardë dollarësh, ishte e siguruar. Uragani që shkaktoi dëmet më të mëdha në vitin 2018 ishte "Michael", që goditi të Floridën në tetor. Supozohet se kjo fatkeqësi natyrore shkaktoi një dëm prej 16 miliardë dollarësh, ndërsa 35 persona humbën jetën nga goditja e stuhisë, transmeton 'ATSH'. Dëmi i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore vitin e kaluar vlerësohet në 160 miliardë dollarë, ndërsa "Munich Re" thotë se këto janë humbje më të vogla krahasuar me vitin 2017, e cila në atë kohë arriti në rreth 350 miliardë dollarë.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**SUPPLY OF STAFF UNIFORMS
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: kzoraqi@tirana-airport.com; srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com specifying, request for information for "Supply of staff uniforms".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

This tender will be organized in two phases:

- In the first phase companies will need to present similar works through uniform samples performed for other companies, letter of references and also a sample of the proposed materials.
- In the second phase short listed companies will need to submit their financial offer together with the sample for Tirana International Airport.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **16:00 hrs. on 25 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
kzoraqi@tirana-airport.com
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

**OPEN CALL FOR TENDER
PREQUALIFICATION**

1. GENERAL CONDITIONS

- Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1
- Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in: Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas
- Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified furniture companies to express their interest in providing the below supply and services:
Office Desk (L-shaped)
Office Desk (160x80x72)
Movable Drawer Locker Unit
Meeting Table
Office etagere
Small Meeting Table (square)
Book Shelves
Swivel Chairs
Regular Fixed Chairs
Stand for working stations division

2 Companies should fulfill the following requirements:

- The products must be certified according to European standards.
- The company should be an authorized service provider for the products it will offer
- Have implemented similar projects in the past.
- Provide evidences of brand certified professionals, who will implement the solution.
- The bidders must provide actual technical brochures of the types and models and specifications of the furniture offered.
- Professional services: To implement successfully all the above-mentioned equipment's and to integrate them accordingly it will be necessary that the bidder be able to quote the necessary services. Therefore, it is needed to quote the following services:
 - Site survey and planning (scheduling)
 - Mounting equipment
 - Testing the deployment
 - Installation report

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3 The due date for submitting the application is 24 January 2019. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Furniture and Equipment", addressed to:
**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,
Rr. Skenderbeg, No. 21/1
Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**

**MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ**

**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID**

BalkanWeb.com
BW

FALAS









MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Receta e çajit që zhduk
problemet në sistemin e
tretjes

KESHILLA



ISHP, si të
ruani shëndetin
nga i ftohti dhe
ngricat

ALBANA DUNI:



◆
Gastohepatologia:
Këshilla të thjeshta
për të përmirësuar
gjendjen
shëndetësore

Si trajtohen çrregullimet e traktit gastro-intestinal

"Kujdes, ja rreziqet që shfaqen
nëse nuk kuroheni në kohë"

Konsumoni boronicat kundër sëmundjeve tumorale e kardiovaskulare

Gastohepatologia: Këshilla të thjeshta për të përmirësuar gjendjen shëndetësore

Voltiza Duro

ALBANA DUNI: Si trajtohen çrregullimet e traktit gastro-intestinal

"Kujdes, ja rreziqet që shfaqen nëse nuk kuroheni në kohë"

Rreth 40% e personave të moshës së tretë vuajnë nga çrregullimet e traktit gastro-intestinal. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon se ankesat më të shpeshta nga të moshuarit përfshijnë diarrenë, inkontinencën fekale, refluksin g-e (pirozë, dhimbje retrosternale) çrregullimet e gjëllitjes, humbjen e oreksit, të vjella apo dhe dhimbje abdominale.

Ajo shton se refluksi ndodh shpesh te të moshuarit e me kalimin e kohës shkakton inflamacion, i cili redukton dhe dëmton mukozën e ezofagut. Duni më tej jep disa këshilla të vlefshme për trajtimin e çrregullimeve të traktit gastro-intestinal.

Cilat janë moshat më të prekura nga çrregullimet e traktit gastro-intestinal? Shumë nga ankesat gastro-intestinale mund të jenë si rezultat i proceseve normale të moshës, por edhe domethënëse për probleme serioze që mund të ketë personi i moshuar. Kjo do të thotë që nuk duhen neglizhuar. Këto ankesa mund të limitojnë cilësinë e jetës së personit të moshuar. Të moshuarit shfaqin më shumë sëmundjet të traktit digjestiv sesa të rinjtë. 40% e personave të moshës së tretë do të kenë të paktën një simptomë gastro-intestinale çdo vit.

Mund të përmendni disa prej shqetësimeve më të shpeshta që kanë pacientët?

Ankesat më të shpeshta përfshijnë: konstipacionin dhe/ose diarrenë, inkontinencën fekale, refluksi g-e (pirozë, dhimbje retrosternale) çrregullimet e gjëllitjes-disfagi, humbjen e oreksit, nauze/të vjella apo dhe dhimbje abdominale.

Cilat janë sëmundjet më të shpeshta që shfaqen te personat mbi 65 vjeç?

Sëmundjet më të shpeshta mbi moshën 65 vjeç janë: refluksi gastro-efozageal, hemorragjia gastro-intestinale, divertikuloza e divertikulitit, tumorët si dhe sindromi i zorrës së irrituar.

Mund të na tregoni disa prej rreziqeve që mund të sjellë diarreja?

Diarre do thotë dalje të shpeshta dhe të ujshme mbi tri herë në ditë. Me rëndësi

të veçantë tek pacientët e moshuar me diarre është rreziku i dehidrimit. Në qoftë se simptomat si etja, lodhja, marramendja, palpacionet dhe këputja trupore shoqërojnë diarrenë, atëherë është e rëndësishme kontaktimi me stafin mjekësor. Diarretë e rënda mund të jenë kërcënuese për jetën, shpesh e çojnë personin në gjendje delirante për shkak të humbjes së likuideve, në rrezime e më pas në fraktura.

Si bëhet trajtimi i saj?

Në varësi të shkakut, mjeku mund të përkrahë: antidiarrike ose antispazmatike. Antibiotikët gjithashtu mund të rekomandohen, grupi i ushqimeve BRAT (banane, oriz, pure molle) gjithashtu mund të rekomandohen edhe lëngjet e kthjella. Por, nëse diarrea vazhdon, atëherë kërkohen nga mjeku ekzaminime dhe analiza si: ekzaminimi i feçes, i gjakut, testet e intolerancës ushqimore e deri në ekzaminimin endoskopik të zorrës. Kolonoskopia bëhet për të përjashtuar patologji të tilla si koliti ulçeroz, tumorët, polipet, divertikujt e zorrës etj.

Çfarë e shkakton konstipacionin te të moshuarit?

Konstipacioni është më shumë i shpeshtë tek të moshuarit sesa në moshat e reja. Ashtu sikurse edhe diarrea është e rëndësishme të determinohet se çfarë të moshuarit kuptojnë kur thonë se kanë konstipacion. Jashtëqitjet e rralla në numër (mbi tri ditë) dhe të thata në konsistencë zakonisht janë prej konstipacionit, të cilat mund të vijnë si rezultat i disa shkaqeve ku përfshihen:



Albana Duni

dietë e varfër në fibra; marrje të pakta në sasi të lëngjeve, medikamentet siç është hekurit ose antiacidet, fecal impaction, carcinoma apo dhe depresioni.

Si mjekohet konstipacioni?

Trajtimi i konstipacionit mund të përfshijë rritjen e sasisë së lëngjeve dhe fibrave në dietë dhe uljen e rregullt në tualet për të defekuar. Mjeku gjithashtu

inë rekomandohet laringo-efozago-gastroskopia. Shkaqet e disfagisë janë efozageale dhe ekstra efozageale si: kanceri oral, i laringut dhe i efozagut, spazmat efozageale, refluksi gastro-efozageal, infarkti cerebro-vascular, sëmundja e Parkinsonit si dhe Alzheimeri.

Si bëhet trajtimi i refluksit gastro-efozageal?

Refluksi ndodh shpesh te të moshuarit, edhe pse nuk është një ndryshim normal i moshës. Ai ndodh kur sfinkteri i poshtëm efozageal nuk mbyllet mjaftueshëm duke lejuar lëngjet gastrike, të cilat janë acide, të kthehen lart në efozag. Me kalimin e kohës, refluksi shkakton inflamacion, i cili redukton dhe dëmton mukozën e efozagut. Simptomat tipike të refluksit janë: djegie kraharori, dhimbje retrosternale, regurgitim i materialeve acide. Në qoftë se regurgitimi ndodh, shpesh dhimbja e shkaktohet prej tij mund të imitojë atë të një ataku në zemër. Simptomat mund përkeqësohen pas një vakti të madh ushqimi me përmbajtje të lartë yndyrore ose pikante dhe pas konsumimit të alkoolit. Ndryshimet e mëposhtme në dietë mund të jenë efektive: shumë proteina, sa më pak yndyra, evitimi i duhanit, alkoolit dhe i çokollatës, ngrënia në sasi të pakët dhe shpesh lejon një tretje më të lehtë, mbajtja e një peshe trupore normale, ngritja e kokës së krevatit gjatë natës, shmangia e shtrirjes deri në dy orë pas ngrënies, mosveshja e rrobave shumë të ngushta apo korseve mund të ndihmojnë në lehtësimin e simptomave.

Kur rekomandohet kurimi me medikamente apo dhe kirurgjia? Për trajtimin medikamentoz, ka një sërë opsionesh të cilat janë: antiacidet, bllokuesit e histamines siç është ranitidina ose PPI siç është omeprazoli. Përfundimisht, kirurgjia mund të jetë e indikuar në rastet me hernie të madhe hiatale, në të cilat stomaku protuberant nën junksionit gastro-efozageal. Te të moshuarit monitorimi i kësaj sëmundjeje është shumë i rëndësishëm, pasi ajo mund të çojë në ulcerat peptike ose në kacerin e stomakut.





Mjeku popullor: Basani, si mund ta përdorni për qetësimin e ankthit e stresit

Voltiza Duro

Lule basani është bimë barishtore shumëvjeçare e familjes Hypericaceae (Guttiferae). Në vendin tonë kjo është një bimë që rritet gjerësisht në zonat e ulëta. Periudha që mblidhet lule basani është në fund të majit dhe në fillim të qershorit. Bima mund të përdoret e thatë ose e njomë. Kur është e njomë, sasia e bimës që përdoret duhet përgjysmuar, pasi përbërësit kimikë janë më të fuqishëm në bimën e njomë. Kësaj bime i përdoren vetëm majat e lulëzuara për veti kurative. Kjo bimë rritet e gjatë deri në 50 cm, por pasi mblidhet, pritet rrënja e bimës dhe një pjesë e kërcellit që nuk përmban lule (rreth 20-30 cm të gjata) dhe thahen në hije. Lule basani përmban shumë përbërës fitokimikë. Ndër këta, në sasi më të mëdha gjenden derivate të floriglucinoilit në sasinë 0.2-4%, flavonoide (2-4%), taniin, proantocianidina, acid klorogjenik amino acide dhe vaj esencial (0.1-0.3%).

EFEKTET KIMIKE

Lule basani është një bimë çudibërëse. Ka efekte në të gjithë organizmin dhe një përdorim shumë të gjerë. Ndikon në sistemin e tretjes, ka efekte qetësuese në organizëm, prandaj ndihmon në ngërçet e stomakut, ndihmon në djegiet e tij gjithashtu. Kjo bimë ndihmon në shërimin e ulcerës dhe gastritit e prandaj këshillohet të përdoret pothuajse çdo ditë për rreth 45 ditë nga individët që vuajnë nga stomaku. Nëse keni djegie apo kthim të ushqimit, bima ndihmon në rregullimin e funksionit të muskujve të stomakut, duke i qetësuar ato, duke sinkronizuar kështu mbylljen dhe hapjen e këtyre muskujve. Lulja e basanit ndikon në rigjenerimin e mukozave të brendshme të organeve, kështu ul inflamacionin e brendshëm. Nëse konsumoni shumë kafe gjatë ditës, e cila rrit inflamacionin e organeve të brendshme dhe rrit gjendjen e hipëraktivizimit, mund të zëvendësoni një kafe me një gotë çaj me lule basani dhe kështu e ndihmoni trupin tuaj të qetësohet dhe të vazhdojë punën normalisht. Rezultatet në sistemin nervor Bima ndihmon në qetësimin e

YLLI MERJA:

Receta e çajit që zhduk problemet në sistemin e tretjes

"Shëron ulcerën, djegiet e stomakut dhe gastritin"



Vllji Merja

sistemit nervor. Ndikon në qetësimin e ankthit dhe stresit, ndikon direkt në sistemin nervor duke e qetësuar atë, pa shkaktuar efekte anësore. Në rast se keni probleme me pagjumësinë apo keni një situatë stresuese, e cila ju ndikon në gjumin tuaj mund të përdorni çdo natë për 30 minuta deri në 1 orë para gjumit një gotë me çaj lule basani. Kjo ndihmon në një gjumë të qetë e në largimin e gjendjeve stresuese. Bima ndikon në rregullimin e sekretimit të hormoneve nga truri, prandaj edhe ka efekte

qetësuese. Kështu, ndikon në rregullimin e menstruacioneve, sidomos te femrat që kanë rregullime hormonale dhe kanë vonesë të ciklit menstrual.

VAJI I BASANIT

Lule basani përdoret e plotë, ose e copëtuar. Mund të përdoret si çaj, ose mund të përdoret vaji i bimës. Doza ditore për të rriturit është 2-4 gramë material bimor. Zakonisht, 1 lugë çaji në një gotë me ujë. Rekomandohet 1-2 gota në ditë para ushqimit. Për të përgatitur vaj basani veprojmë kështu: mer-



ret lulja e basanit e njomë, priten me gërrshërë vetëm lulet e bimës dhe hidhen në një enë qelqi, mbyllohen komplet lulet me vaj ulliri dhe lihet përzjerja në diell për 45 ditë. Pas 45 ditësh kullohet vaji dhe ruhet në errësirë. Nga ky vaj konsumohet 1 lugë gjelle në mëngjes çdo ditë përpara ushqimit. Vaji i lule basanit mund të përgatitet edhe me lulen e thatë të bimës, mjafton që përpara se ta futni në vaj, lulet e bimës duhet të futen në ujë të valuar përpara për 2-3 minuta. Pastaj lihet të kullojë pak ujë dhe futen menjëherë në vaj ulliri. Vaji i lules së basanit përdoret edhe për përdorim të jashtëm. Përdoret në trajtimin e plagëve, djegieve dhe

pezmatimeve të lëkurës. Vaji i lules së basanit është shumë i fuqishëm në mbylljen e plagëve, ndihmon në rigjenerimin e qelizave të mukozave të brendshme. Përdoret në kremra rigjenerues për plagë si dhe për rigjenerimin e kurimin e hemorroideve në fund të zorrës së trashë. Është ushqyes e rigjenerues i zorrës së trashë. Kremi kundër hemorroideve arrin të hyjë në thellësi të zorrës, pasi përthithet shumë shpejt nga zorra e trashë. Ky krem e ushqen, lubrifikon dhe mbyll plagët e brendshme në zorrë.

Gjatë dimrit organizmi dhe zemra punojnë më shumë për të përballuar të ftohtin. Kjo mund të jetë veçanërisht e rrezikshme për të moshuarit dhe të sëmurët kronikë. Nëse qëndroni gjatë në të ftohtë, temperatura trupore mund të bjerë nën 35° C e me kalimin e kohës organizmi nuk funksionon më siç duhet duke rrezikuar shëndetin; shkakton ngushtim të enëve të gjakut dhe përshpejtim të ritmit të zemrës. Gjatë qëndrimit jashtë, pjesët më të ekspozuara si koka, këmbët e duart mund të ngrijnë. Në fillim ato humbasin ndjeshmërinë, skuqen dhe dhembin, e më pas ngrijnë duke u bërë gri dhe të padhimbshme. Nëse kryeni sforcim fizike në ambiente të jashtme, rrezikoni të përkeqësoni sëmundjet e zemrës. Dimri dhe temperatura e ftohta mund ta dëmtojnë shëndetin tuaj, por ju mund të jeni mirë nëse ndiqni këto këshilla të dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik:

- Vishuni ngrohtë dhe përdorni shall, doreza dhe kapuç kur jeni në ambiente të jashtme dhe të ftohta.
- Evitoni të qëndroni gjatë në ambiente të jashtme në ditët e ftohta, me erë dhe sidomos kur jeni të lagur.
- Evitoni të dilni jashtë në orët e para të mëngjesit dhe orët e vona të darkës.
- Eoni me kujdes e me hapë të vegjël dhe duart jashtë xhepave.
- Ushqehuni me ushqime të ngrohta e të lëngshme të përbëra nga mish, bishtajoret, perimet, drithërat, por edhe fruta që përmbajnë vitaminë dhe minerale.
- Pini sa më shumë ujë dhe lëngje, sidomos nëse jeni të sëmurë dhe qëndroni vazhdimisht në shtëpi.
- Qëndroni në ambiente të ngrohta dhe të ajrosura herë pas here. Temperatura ideale për ambientin e brendshëm është 20-23° C dhe ajrosja duhet të bëhet disa herë për të siguruar lagështinë e duhur për rrugët e frymëmarrjes dhe për të ulur përqendrimitin e mikrobeve në shtëpi. Mund të mbani një enë me ujë tek radiator për të siguruar lagështinë e ajrit. Sigurohuni gjithashtu që dyert dhe dritaret të jenë të izoluar sa më mirë. Edhe mbingrohet e shtëpisë mund të jenë të



ISHP, këshillat si të ruani shëndetin nga i ftohti dhe ngricat

dëmshme, ashtu si dhe ngrohet me dru apo gaz, që mund të çlirojnë gazra të dëmshme për organizmin. Ndaj duhet që ambientet e brendshme të ajrosen mirë disa herë gjatë ditës dhe të siguroheni që nuk keni rrjedhje gazrash. Disa nga sëmundjet që mund të shfaqen ose përkeqësohen si pasojë e të ftohtit në dimër janë:

- Sëmundje të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes: skuqje apo dhimbje deri në infeksion të bajameve, veshëve, hundës dhe sinuseve (sinuzite).
- Sëmundje të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes: gripi dhe viroza të ndryshme, acarim i astmës deri në infeksione të mushkërisë.
- Dhimbje koke si pasojë e spazmave/ngushtimit të enëve të gjakut në kokë.
- Rritje e tensionit arterial dhe përkeqësim të tij tek të sëmurët kronikë.
- Shtërngime gjoksi deri në infarkte të zemrës.
- Probleme të qarkullimit të gjakut si: morthi, sklerodermia etj..
- Fraktura, ndrydhje dhe dëmtime të tjera si pasojë e rrëshqitjeve në akull.
- Ngrirjet e ekstremiteteve deri në amputime (prerje) të tyre. Nëse sëmurëni me grip apo një nga virozat e stinës:
- Përdorni medikamente për të ulur temperaturën- Paracetamol kur ajo të rritet mbi 38-38,5° C. Nëse tem-



peratura zgjat për më shumë se 3-5 ditë dhe është mjaft e rrebelë, atëherë drejtohuni tek mjeku i familjes.

-Për të qetësuar kollën, përdorni qumësht me mjaltë, çaj me sherebelë, dafinë, bliin etj. dhe ajrosni herë pas here ambientet.

-Ushqehuni më mirë dhe me sa më

cilin duhet të konsultoheni patjetër me mjekun tuaj.

-Nëse keni probleme të qarkullimit të gjakut si: morthi, sklerodermia etj., nuk duhet të dilni nga shtëpia pa përdorur kremrat e këshilluar nga mjeku dhe duhet të mbani sa më ngrohtë pjesët e ekspozuara duke përdorur dorashka leshi, shall, kapuç etj..

-Nëse qëndroni gjatë në të ftohtë, organizmi juaj nuk arrin të prodhojë aq nxehtësi sa harxhon dhe ju do të filloni të vuani nga ulja e temperaturës trupore e me kalimin e kohës do të ndihenit të lodhur, të mpirë dhe konfuzë. Kjo, pasi si pasojë e ngushtimit të enëve të gjakut në tru, ai fillon të mos mendojë qartë dhe pastaj lëvizjet fillojnë të ngadalësohen, deri kur temperatura e trupit të bjerë nën 35° C deri në ngrirje. Shenjat e para të ngrirjes janë mungesa e ndjeshmërisë, skuqja dhe dhimbjet në indet e lëkurës dhe nënlëkurës në ekstremitete (kokë, këmbë e duar) dhe zonat më të ekspozuara si fytyra, veshët, etj. Në raste të tilla nuk duhet të masazhohen pjesët e ngrira, por duhet të futeni menjëherë në një ambient të ngrohtë dhe të pini pije të ngrohta që të rrisin temperaturën e trupit, duke evituar përdorimin e alkoolit. Kujdes, nëse lëkura merr ngjyrë të zbehtë deri në të verdhë- jeshile, pasi mund të shkojë deri në gangrenzim që kërkon dhe amputimin e tyre.

shumë lëng mish (sidomos lëng pule), fruta, perime, duke mos harruar edhe shtimin e lëngjeve. Disa ushqime me veti anti inflamatore apo antimikrobiale, shumë të mira për mbrojtjen imunitare janë: xhinxheri, mjalti, hudhra, qepa, agrumet, lakra, specat, mollët dhe dardhët e pjekura, ekinacea etj..

Futni këmbët në ujë të ngrohtë për 10 minuta në darkë.

-Mos përdorni antibiotikë pa këshillën e mjekut.

-Në rastet kur temperatura e pacientit vazhdon të mos bjerë, fillon të shfaqet vështirësia në frymëmarrje, dhimbje veshi, fyti, koke, apo kraxharori dhe gjendja e përgjithshme rëndohet, atëherë mund të keni një infeksion të rrugëve të sipërme apo të poshtme të frymëmarrjes, për të

Këshilla



Shafrani me mjaltë, antibiotiku i fuqishëm natyral

Përderisa antibiotikët konvencionalë janë duke u përdorur së tepërmi, ilaçet natyrale si mjalti dhe shafrani janë tejet fitimprurës dhe e përmirësojnë shëndetin në shumë mënyra. Mjalti në mënyrë efektive lufton infeksionet pa shkaktoar baktere rezistente, ndryshe prej antibiotikëve konvencionalë. Një studim i publikuar në revistën "European Journal of Clinical Microbiology and Infectious Diseases" ka zbuluar se mjalti e ka shkatërruar çdo baktere apo patogjen në të cilin e kanë testuar. Hulumtuesit kanë zbuluar se kjo mund të aplikohet në përditshmëri. Sipas ekspertëve, produktet e bazuara me mjaltë në shumë raste mund t'i zëvendësojnë kremrat me antibiotikë për plagë. Në anën tjetër, edhe shafrani është një mrekulli tjetër natyrore, që sjell shumë përfitime shëndetësore. Përbërësit më të rëndësishëm të shafranit quhen curcuminoide



dhe kanë fuqi shëruese, antioksiduese, antipezmatuese, antiseptike, antibakteriale dhe veti antikërpudhore. Kombinimi i këtyre dy produkteve - pra mjaltit e shafranit, mund të sjellë në krijimin e një antibiotiku natyral shumë të fuqishëm. Ekspertët thonë se ilaçi natyral me këta dy përbërës mund të përdoret për luftimin e shumë sëmundjeve, duke përfshirë problemet me tretje, gripin, astmën, hipertensionin, sheqerin në gjak, artritin,

diabetin, sëmundjet e zemrës, depresionin dhe ankthin, inflamacionin e plagëve dhe djegjet, ekzemën, aknet, etj. Përbërësit:

- Një lugë gjelle shafran.
- $\frac{1}{4}$ e gotës mjaltë.
- Dy pika vaj esencial limoni.

Përgatitja:
I përzieni mirë përbërësit dhe i mbulonit me diçka. Produktin e vendosni në temperaturë dhome dhe e përzieni para çdo përdorimi. Për ta luftuar gripin apo ftohjen, merrni gjysmë lugë gjelle nga ky ilaç disa herë në ditë.



Konsumoni boronicat kundër sëmundjeve tumorale e kardiovaskulare

Boronicat janë të ëmbla, ushqyese dhe shumë të shëndetshme. Këto fruta i bëjnë kaq mirë trupit dhe mendjes sonë, e ndihmojnë trurin dhe zemrën, mbrojnë sytë dhe lëkurën. Antioksidantët që gjenden te boronicat, sidomos ato që rriten të egra në tokat shqiptare janë aq të forta sa janë të afta për të neutralizuar radikalet e lira që lidhen me zhvillimin e disa sëmundjeve kardiovaskulare apo tumorale. Ato kanë kapacitetin më të lartë antioksidant ndër të gjitha frutat dhe perimet që konsumojmë zakonisht. Kjo ndihmon shumë në mbrojtjen kundër plakjes dhe ndaj tumoreve. Dëmtimi i qelizave është pjesë e jetës së përditshme. Madje, kjo ndodh dhjetëra mijëra herë në ditë, në çdo qelizë të trupit. Dëmtimi i qelizave është pjesë e arsyes që ne plakemi më herët apo më vonë dhe ky dëmtim luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sëmundjeve tumorale. Në një studim Universitetit Mjekësor të Cleveland, SHBA, individë me rrezik të lartë për sëmundje të zemrës vërejtën një ulje 4-6% të tensionit të lartë, pas konsumimit të 50 gramë boronica në ditë, për tetë javë. Antioksidantët përbërës të boronicave duket se kanë ndikime pozitive në funksionimin e trurit. Ato vonojnë rënien e funksioneve të tij të lidhura me moshën. Një studim që zgjati gjashtë vjet, ku morën pjesë 16,010 të moshuar vërtetoi se boronicat dhe luleshtrydhet vonuan plakjen me deri 2.5 vjet. Boronicat kanë shumë më pak sheqer krahasuar me frutat e tjera. Një kupë përmban vetëm 15 gramë sheqer natyral, aq sa një mollë e vogël apo një portokall.

INTERVISTA SPECIALE

Historia e panjohur e familjes Butka nga i famshmi "Plaku i Butkës" i pushkës dhe i librit, tek i biri, Safeti, shok i Lasgush Poradecit në Graz të Austrisë

Uran Butka: Ju tregoj sagën e familjes Butka nga gjyshi Saliu, te babai Safeti

Dëshmia: Safet Butka pas diplomimit në Austri, shërbeu si mësues dhe drejtor shkolle në Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër e Tiranë dhe u internua në Ventotene si antifashist

Dashnor Kaloçi

Historian, studiues, publicist, shkrimtar, piktor, politikan dhe ish-deputet, Uran Butka, një nga personazhet publike mjaft të njohur pas viteve '90-të, edhe pse mban plot tetë dekada mbi supet e jetës së tij, vazhdon përsëri të punojë, madje me energji të jashtëzakonshme sikur kërkon t'i bëjë sfidë jo vetëm moshës, por edhe gjithë asaj periudhe kohe të errët për të, të para viteve '90-të, kur regjimi komunist ia kishte privuar të drejtën e shkrimeve, studimeve dhe librave, prej të cilave ai thotë se do jenë bashkudhëtar të tij të pandarë deri në fund të jetës, sa të ketë frymë gjallë. I zhytur mes librave në studion e tij të punës, diku në qendër të kryeqytetit pranë Institutit "Lumo Skëndo", që ai drejton prej pak vitesh, duket se ende nuk e ka marrë veten nga një punë tëjet e çmuar për të, madje do të thoshim pa e tepruar edhe një ëndërr e tij, ajo e sjelljes në atdhe të eshtrave të Mit'had Frashërit, idhullit të tij dhe njëkohsisht kreut të nacionalizmit shqiptar. Autor i shumë librave, si atyre me studime të karakterit historik, por edhe letrarisë me romane dhe libra me regjime, Uran Butka pothuaj nuk ka folur dhe shkruar kurrë për jetën e tij. Kjo është edhe një nga arsyet që na shtynë të takohemi dhe të realizojmë këtë intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", (në tre numra radhazi) por jeta me historitë e tij personale, nuk mund të shkëputet kurrsesi nga saga e familjes Butka, të cilët janë quajtur me të drejtë si gurë të fortë e të çmuar në themelet e historisë shqiptare. Kështu, në këtë kontekst, po e fillojmë nga rrënjët e kësaj familje?

Zoti Uran, cila është familja Butka?

Sipas Sami Frashërit, kur të parët e Frashërlinjve u vendosën në Frashër të Dangëllisë, rreth vitit 1650, gjetën atje Aliçkasit autoktonë. Kur Frashëri ra ekonomikisht, atëherë familja Aliçka u zhvendos në fshatrat Butkë dhe Orgockë të Kolonjës, më vonë edhe në Kosovë. Ndërsa familja Frashëri u shpërngul në Janinë e më pas në Stamboll. Gjyshi im, Sali Butka, fillimisht është quajtur Sali Tahir



Uran Butka

Aliçka, mandej, kur u bë i njohur në Kolonjë e më gjerë, u mbiquajti Sali Butka.

Për çfarë u bë i njohur Sali Butka?

Ai ishte një rilindës i ushqyer me veprat e Samiut, Naimit, Jani Vretos e të tjerë dhe u bë një përhapës i kulturës së Rilindjes, librave, shtypit dhe shkollave shqipe në Kolonjë e Korçë, bashkë me Petro Nini Luarasin dhe Jani Cico Kosturin. Në vitet 1893-1895 ata hapën 5 shkolla shqipe në Kolonjë. I mbronte nga qeveria turke dhe patrikana greke pushka e Sali Butkës, ndërkohë që

Sali Butka sillte fshehur nga Manastiri libra shqip për shkollat e para shqipe. Kështu e filloi ai aktivitetin rilindës, qysh në fund të shekullit të 19-të.

Cili është roli i Sali Butkës në Komitetin e fshehtë të Manastirit?

Sali Butka u bë anëtar i Komitetit të fshehtë të Manastirit, që u themelua në vitin 1905 me në krye patriotin Bajo Topulli. Vendimi i këtij komiteti ishte krijimi i cetave të para kryengritëse. Bajo Topulli shkoi në dhjetor 1905 në shtëpinë e Sali Butkës dhe në janar të vitin

1906 në Butkë u themelua çeta e parë kombëtare. Në vitin 1907 shkoj atje edhe çeta e Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos, që i dhanë lëvizjes për liri, zhvillim të rëndësishëm dhe përgatitjen thirrjen e Kongresit të Manastirit në 1908, me në krye Mit'had Frashërin, kongres që përcaktoi edhe alfabetin latin dhe hapjen e shkollave shqipe. Sali Butka menjëherë e përvetësoi këtë alfabet edhe vjershat e shkrimtar e botuara tek "Kalendari Kombiar", gazeta "Liria e Shqipërisë" etj., i botonte me këtë ABECE të njësuar. Kur xhonturqit nisën të mbyllnin shkollat dhe klubet shqiptare dhe kërkimin të përdorë alfabeti arabo-turk, Sali Butka me 2500 kolonjarë marshuan për në Korçë, ku u bë "Mitingu i shkronjave shqipe" prej 10.000 vetash, që kundërshtuan alfabetin e huaj dhe mbrojtën alfabetin e Manastirit. Saliu u përdoq dhe u burgos disa herë nga qeveria turke, por nuk hoqi dorë. Në vitin 1911 ai e zgjeroi çetën e tij glirimtare. Në maj të vitit 1912 mori pjesë me 50 kolonjarë në Kuvendin e Junikut, afër Pejës në Kosovë, që mori vendimin për nisjen e kryengritjes së përgjithshme. Aty u njoh me Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Bajram Currin, me të cilët e vazhdoi bashkëpunimin kombëtar. Në qershor të vitit 1912 u organizua në Frashër komiteti kryengritës i Shqipërisë Juglindore me komandant Sali Butkën.


A ka qenë Sali Butka në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, në nëntorin e 1912-ës?

Para se të ndalem të kjo pyetje, desha t'ju them pak për një ngjarje tjetër. Gjatë rrugëtimit për në

Frashër, u vra në pritë nga komandot turke djali i madh i Sali Butkës, Iljazi, për të cilin nuk vajtoi, po shkroi një këngë: "Na u vra mëmëdhetari, që ish nga shokët m'i pari, shqipëtar bir shqipëtar, i ndritë shpirti dhe varri". Në krye të çetës së Kolonjës Sali Butka çliroi Ersekën dhe Korçën, në gusht 1912. Në Gazetën "Kooha" të 11 gushtit 1912, Mihal Grameno shkruante: "I dëgjua patriot Sali Butka, burrë i thjeshtë shqiptar dhe me zemër mëmëdhetari; shokët e tij ishin të veshur me rroba kombëtare dhe të armatosur me malierka". Më muajin nëntor 1912 u nis me çetën e tij për në Vlorë, për shpalljen e pavarësisë, por arriti me pak vonesë, si Isa Boletini. Në Vlorë ai u prit nga Ismail Qemali dhe qeveria e Vlorës dhe u caktoa tek ura e Mifollit për të mbrojtur shtetin e ri shqiptar nga sulmi i ushtrisë turke të Xhavit Pashës, që vinte nga Fieri, të cilën e theu dhe e ktheu mbrapsht. Ndërkohë, Shqipëria u pushtua në çetën e tij glirimtare. Në maj të vitit 1912 mori pjesë me të madhe nga ushtritë serbe dhe greke. Në ballë të luftës kundër pushtuesve grekë u vu Sali Butka me çetën e tij, me të birin, Gani Butkën dhe vëllanë, Myftar Butkën. U zhvilluan mjaft beteja në Kolonjë, Skrapar, Korçë, siç janë luftërat e Shtikës, Butkës, Qarrit, Luarasit, Qesarakës, Backës, Qafë-Martës, Panaritit, që mbrojnë gjithë vijën e frontit shqiptar. Në betejën e Nikolicës, 24 prill 1914, ushtria e Sali Butkës e mbrojti Korçën nga mësymja e ushtrisë greke.

Kjo është beteja ku Sali Butka u plagos në sy?

Po, pikërisht në këtë betejë Sali



Sali Butka, "Ndjenja për Atdhe"



Safet Butka, student në universitetin e Graz, Austri



Sali Butka me Safetin dhe familjen e tij

Butka u plagos në syrin e majtë, por nuk u tërhoq nga beteja dhe e shpëtoi Korçën e qarkun e saj nga pushtimi grek. Familja Butka kontribuoi edhe në luftën kundër rebelimit haxhiqamilist të vitit 1914-1915. Komandanti i ri, Gani Butka, djali i dytë i Sali Butkës, u vra bashkë me 60 kolonjarë në Pogradecin për të mbrojtur Korçën dhe Pogradecin prej këtij rebelimi antikombëtar. Dëshmor të tjerë i familjes. Saliu ndjeu dhimbje të madhe për humbjen e Ganiut dhe shkroi për të një elegji, që u kthye në këngë: "Malet e Gramozit qajnë".

Cili është roli i Sali Butkës në periudhën 1914-1918, në vitet e Luftës së Parë Botërore?

Kur nisi Lufta e Parë Botërore, Sali Butka me çetat e tij me përkrahjen e austro-hungarezëve nisi luftën për çlirim nga pushtuesit e huaj që kishin shkelur Shqipërinë. Kulmi i kësaj lufte ishte kur çetat e tij, që arritën deri në 30.000 veta, nisën të çlironin me radhë krahinat e Skraparit, Parnaritit, Gorës, Oparit, për të arritur në Korçë, ku ndodheshin francezët. Në Voskopojë ishin disa komando grekë, që i penguan forcat kombëtare. Sali Butka i dërgoi një letër pleqësisë, ku shkruante: "Sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, Gjirokastra dhe Korça i mbetet Shqipërisë. Pra, edhe Voskopoja duke bërë pjesë të pandarë në qarkun e Korçës, i mbetet Shqipërisë, prandaj si kryetar i çetave shqiptare po vij ta marr në dorëzim me shpresë se ju do të mirëprisni ardhjen tonë". Mirëpo mori këtë përgjigje fyese: "Zoti Butka, morëm letërën tuaj dhe më suam se kishit vendosur të vini në Voskopojë, ju lajmëroj që duhet ta dini se nuk do të lejojmë kurrë, sepse është gynah që me këmbët e ndyra të shqiptarëve të shkelet edhe një pëllëmbë tokë nga Voskopoja antike greke. Nuk do të pranojmë kurrë të tjerë flamur përveç atij grek, do ta mbrojmë deri në pikën e fundit të gjakut tonë". Filloi lufta e nisur nga ushtarët grekë. Ndërkohë një hajdut, që donte të përfitonte, i vuri zjarrin një kasolleje me kashtë dhe zjarri mori gjithë fshatin. Sali Butka hapi një shteg dhe i ndihmoi të gjithë banorët voskopojarë të kalonin për në Korçë. Asnjë voskopojar nuk u vra apo u dogj. Saliu e ndoqi zjarrvënësien edhe e push-



Prof. Safet Butka, i burgosur nga fashistët italianë në Ventotene

katoi me gjyq. Mandej me ushtrinë e tij rrethoi Korçën, bashkë me forcat e Themistokli Gërmenjit dhe i bënë presion autoritetit francez, gjeneralit Deokoën, që të shpallte bashkimin e Korçës me Shqipërinë.

C'ndodhi më pas?

Francezët i ftuan dy komandantët në Korçë për të biseduar. Themistokliu në marrëveshje me Saliun shkoi në Korçë, ndërsa Saliu e mbajti të rrethuar. Gjeneralët francezë Deokoën, Sarai etj. theksojnë se ishte ky presion ushtarak i Sali Butkës dhe diplomacia e Themistokli Gërmenjit që i detyroi francezët të shpallnin vetëqeverimin shqiptar të kazasë së Korçës më 10 dhjetor 1916 dhe më pas bashkimin e saj me Shqipërinë. Kjo ishte një arritje e madhe historike.

Cili është roli i Sali Butkës në Kongresin e Lushnjës?

Sali Butka mori pjesë në Kongresin e Lushnjës si delegati i Kolonjës dhe i Korçës në vitin 1920. Ky kongres e ribëri realisht pavarësinë e shtetit shqiptar dhe e futi në zhvillim demokratike. Sali Butka mbajti një fjalim në ballkonin e bashkisë në Lushnjë dhe u reshtua në radhën e forcave demokratike. Në këtë kohë, Saliut iu duk sikur e kishte përmbushur qëllimin e jetës së tij. Në Korçë botoi librin me poezi "Ndjenja për atdhenë". "Janë vjersha historike, të thëna pikë pas pike, pa drojtje prej asnjë frike", as prej pushe as prej thike", shkruan ai. Megjithatë, zhvillimi i ngjarjeve dhe rreziku që i



kanosej Shqipërisë e bënë Sali Butkën të ishte i paplotësuar. Lidhur me këtë, midis të tjerash, ai shkruan: "Në kohë të pleqërisë/ më erdhën plagë të rënda./ për shkakun e Shqipërisë / që s'u bë siç ma kish ënda". Saliu ndërroi jetë më 20 tetor të vitit 1938, varri i tij është në Ersekë. Është nderuar me "Urdhërin e Skënderbeut dhe me "Urdhërin e Lirisë".

Do të ndalemi tani tek babai juaj, Safet Butka, një figurë tjetër e shquar e familjes Butka?

Po, Safet Butka vazhdoi rrugën e të atit, por e çoi edhe më tej. Punoji në shqua në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare, mandej edhe në luftën për liri. Frymëzim e para i mori nga i ati dhe traditat e Kolonjës. Studimet e mesme i kreu në Graz të Austrisë dhe më pas edhe në universitetin për filozofi. Atje, bashkë me Lazgush Po-

radecin, Krist Malokun etj., formuan shoqërinë studentore dhe botuan përmbledhjen e parë poetike të Naim Frashërit, ku vendin kryesor e zinte studimi i Safet Butkës për jetën dhe veprën e poetit kombëtar. Po atë vit, (1925) këtë studim ai e botoi si libër më vete. Gjithashtu, mori pjesë edhe në lëvizjen studentore të Vjenës, që nxirrte revistat "Djalëria" dhe "Minerva", ku Safet Butka botoi edhe shkrimet e tij të para. Në Austri mori me vete dhe djalin e vogël të xhaxhait, Qemal Butkën, i cili atje kreu shkollën fillore, të mesmen dhe universitetin për arkitekturë dhe u bë një nga arkitektët më të shquar të kohës në Shqipëri dhe në SHBA.

Kur u kthye në Shqipëri, ku u emërua babai juaj, Safeti?

Safeti u kthye në Shqipëri dhe u emërua profesor në Liceun francez të Korçës, ku jepte gjermanisht dhe gjuhën shqipe. Mandej u emërua mësues në shkollën tregtare të Vlorës. Petro Marko, nxënësi i tij, shkruan tek "Intervistë me veten": "Mësuesi i historisë ka qenë Safet Butka nga Kolonja. E deshmë se ishte i biri i Sali Butkës. Ai kishte studiuar në Austri dhe na vinte në klasë me libra të trashë dhe me enciklopedi të tjera. Nuk shoqërohej me profesorët italianë, madje i përbuzte ata".

Babai juaj ka qenë edhe në qytetin e Gjirokastrës?

Po, në vitet 1934-'35, babai u emërua drejtor i shkollës Normale të Gjirokastrës, ku u dallua si një reformator i arsimit. Atje themeloi edhe të parën shoqatë të arsimtarëve në Shqipëri, me të cilën zhvilloi mjaft veprimtari kulturore, si ekskursione për të njohur vendin, vendosjen e pllakës përkujtimore të rrapi i Mashkullorës, ku luftoi çeta e Çerçiz Topullit, përkujtimin e figurave patriotike si Koto Hoxhi, Hasan Tahsin etj. Pastaj u transferua në Ministrinë e Arsimit dhe bashkë me ministrin Mirash Ivanaj realizuan reformën e njohur arsimore. Është quajtur "Pestaloc i Shqipërisë" dhe "Kalorës i arsimit shqiptar". Në një inspektim në shkollat e Matit, inspektori Safet Butka i bëri disa vërejtje kryetarit të bashkisë për mangësitë në shkollat. Në raportin që kryetarit i bashkisë, O. Hoshia, i bente Ministrisë së Brendshme, thuhet: "Desha t'i jap me kuptue inspektorit Safet Butka se me pasjen e Naltnmadhnisë së Tjij Zog I në fron, gjithë interesat e shtetit janë plotsue dhe do plotsohen. Por ai m'u përgjigj jashtë edukatës si nëpunës i naltë që ishte, tue thanë kundra frontit mbretnuer: A veç mbreti të rrojë, por ma parë duhet të rrojë shteti!". Kjo gjë është e dokumentuar edhe në Arkivin Qendror të Shtetit, f.252, d.83, viti 1936.

Po në gjimnazin e Tiranës, në ç'periudhë ka shërbyer babai juaj, Safeti?

Po, vitet e fundit në arsim, babai ishte drejtor i Gjimnazit Shtetnuer të Tiranës, pra në periudhën 1938-'39, që asokohe ishte edhe shkollë më e rëndësishme e vendit. Në kohën para pushtimit italian, ai udhëhoqi demonstratat e studenteve dhe të qytetarëve të Tiranës, nga 3 deri 6 prill 1939 kundër pushtimit fashist me thirrjet "Poshtë fashizmi!", "Duam armë!" dhe nuk pranoi të nderonte al-fashistët, si edhe u bëri thirrje studentëve të mos nderonin pushtuesit. Edhe kjo gjë është e dokumentuar, në AQSH, f. 295 d.565 viti

1939. Po kështu, Mirash Ivanaj ka mbajtur një ditar që e ka titulluar, "Na, që e gjetëm shpëtimin në t'lkun", ku shkruan: "Na e martë, 4 prill 1939. Edhe sot e të tanë ditën, edhe natën deri pas mesnatës shfaqjet e popullit ndoqën njëna tjetrën, me nxënësit e shkollave të mesme të prirur prej Safet Butkës, gjakut trimosh dhe dëshmorësh që pasqyrohet Shqipëria dhe populli shqiptar". Safeti ishte një atdhetar dhe antifashist i orëve të para. Italianët e pushuan si drejtor të Gjimnazit të Tiranës dhe e dërguan përkohësisht gjimnazin e Shkodrës.

Po në Shkodër, cili ishte aktiviteti antifashist i Safet Butkës?

Edhe në Shkodër pati një aktivitet mjaft të gjerë si antifashist. Kur ai vajti në Shkodër, fillimisht pati një takim me Fishtën, i cili i dhuroi "Lahutën e Malcis" me dedikimin "Me përvujtni, Safet Butkës". Me 28 nëntor 1939, Safeti u priu përsëri demonstratave të studentëve dhe të qytetarëve në Shkodër, gjë që e përsëriti edhe në janar të 1940. U arrestua nga italianët dhe u burgos në Ventotene, një ishull ku internonin antifashistët. Theksoj që në Ventotene ai vazhdoi të mban-te po atë qëndrim, të mos nderonte al-fashistët, sepse "ne s'mund të nderojmë pushtuesit", thoshte ai dhe të bashkëpunonte me antifashistët evropianë. Në Ventotene u hartua "Manifesti i Ventotenes", projekti i Evropës së Bashkuar dhe demokratike, në të cilin kanë kontribuar Spineli, Pertini, si edhe shqiptarët Llazar Fundo, Safet Butka etj., themelues të Bashkimit Evropian, ku ne rropatemi sot të shkojmë.

Gjatë kësaj kohe, a kishte informacion Safeti se ç'ndodhte me familjen e tij në Shqipëri?

Po, patjetër, kishte informacion me anë të korrespondencës me letra, që mbante rregullisht me familjen. E shoqja, Hatixheja, i shkruante në një letër se, ndërsa shokët e tij po liroheshin, ai mbetet në burg. Safeti ia kthente se "ishte kokëdhë". Madje, i shkruante që ajo t'i shiste Kolë Kamsit enciklopeditë dhe librat e tij, që kishte blerë në Austri, që ajo të shlyente kredinë e bankës, që kishin marrë për të ndërtuar shtëpinë në Tiranë. Ai si qytetar kishte merakun e larges së kredisë, ndonëse i burgosur në Itali, kur s'kishte as bankë shqiptare, as Shqipëri. Por nëna shiti gjerdanin e florinjit e martesës tek një argjendar, në vend të shiste librat dhe ato libra janë në bibliotekën time.

Kur u kthye në Shqipëri nga internimi?

U kthye në Shqipëri në fund të vitit 1942 dhe u takua në Tiranë me Mid'hat Frashërin. Natyrisht, në Shqipërinë e pushtuar, ai zgjodhi alternativën nacionaliste, sepse atëherë ishin dy alternativa politike, nacionaliste dhe komuniste. Nacionalistët i kanë shërbyer Shqipërisë qysh nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndoshta edhe më herët, për të mbrojtur identitetin dhe trojet kombëtare, më vonë në lëvizjen për liri, pavarësi e shtet shqiptar, në Kongresin e Lushnjës e luftën e Vlorës, në lëvizjen për demokraci e drejtim perëndimor e kështu me radhë. Ishte edhe alternativa komuniste, e cila vinte nga jashtë, drejtohej nga Internacionalja komuniste në Rusi, ku stalinizmi kishte shkakutuar 20 milionë viktima etj.

(vijoj nesër)

Opinion i Ditës

Pse Rama i urren Lubonjën e Bushatin më shumë se neve të tjerëve?

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

... bëj asgjë, i vizitot televizionet e Shqipërisë. Aty, të premtëve, mund ta takosh Iva Alikon, Linda Morinën, por edhe Edi Ramën. Po flas për emisionin "Zonë e Lirë", me autor Arian Çanin. Aty para një jave ishte Linda (jo bashkëshortja e Edit), mbrëmë ishte Edi.

Parimisht Linda dhe Edi nuk mund të krahasohen. Të dy janë artistë, por Linda është pakrahsimisht më e dobët, ndonëse më e ndershme dhe më e pazarrar. Ajo aktrimin e ushtron me forca vetjake, derisa Kryeministri i Shqipërisë me taksa të shqiptarëve.


Dallimi tjetër në mes këtyre dyve është që kur shfaqen në studio televizive, gazetarët abuzojnë me Lindën, kurse Edi abuzon me gazetarët. Kjo për faktin se Linda nuk i njeht pronarët e gazetarëve, ndërsa Edi po.

Gazetarët janë kafshë interesante. Kur e kanë para vetes llojin e Lindës, ose Iva Alikos, është fantastike t'i shikosh se si ndihen të pacensurë dhe me liri të plotë të shprehjes, duket se po përjetojnë orgazëm. Janë në gjendje t'ua bëjnë të gjitha pyetjet që u bien ndër mend. Mënyra se si gazetarët i marrin në pyetje ato, ose ndonjëherë edhe ata, se si i intervetojnë, se si i bëjnë "horë" para botës, është një perversitet i llojit të vet. Të kënaqesh kur ia ekspozon botës një person me aftësi të kufizuara do të duhej të cilësoje si një "krim federal".

Në anën tjetër, kur në po të njëjtën studio, kur në po të njëjtën karrige ul menderet kryeministri i shtetit, prapë në vazhdojmë të kemi një abuzues dhe një të abuzuar, përveçse këtë herë i abuzuari është gazetari. Tash e kemi raportin e përmbysur. Gazetari më duket si Linda Morina, ose Iva Aliko, kurse kryeministri është perversi. Është ky i fundit, që gëzon liri të plotë të shprehjes, që është i sigurt që askush nuk do t'i thotë që duhet të liros studioin sepse iku koha që e kisha rezervuar për ty. Mund të jetë e kundërta, që Rama ta thërrasë pronarin dhe t'i thotë mbylle këtë emision, sepse mjaft ishte për sonte.

Të premtën, pra, kur po e ndiqja kryeministrin Rama derisa po e bënte selektimin final dhe suprem se kush ishte Kadri dhe kush nuk ishte Kadri, isha i nderuar që në "Top Listën" e Ramës të gjendesha në anën e Kadriëve.

Për lexuesit nga Kosova duhet ta sqaroj se kryeministri shqiptar, Edi Rama, i ka kategorizuar shqiptarët në Kadriinj dhe jo-Kadriinj. Kadriinj në librat e Ramës është një person i pagdhundur, malok, i keq, i parruar, i pambajtur, i paveshur



dhe çdo gjë tjetër që e ka një "pa" përpara. Pse Rama e ka zgjedhur për protagonist Kadriun, e jo ta zëmë Stefanin, a Dhimitrin, kjo është një mesele në vetvete. Kadri është një emër mysliman, që gjendet kryesisht në pjesën verilindore të Shqipërisë, e posaçërisht edhe në Kosovë. Madje, në Kosovë është edhe një Kadri mjaft i njohur kryetar i Kuvendit. Madje, protagonistin fillestar i Ramës quhej saktësisht Kadri Veseli, ashtu sikur edhe quhet kryetari i Kuvendit të Kosovës. Për Ramën, Kadriu, Hasani, Muhamedi, Ibishi dhe të tjerët që i kanë emrat e

vjetër myslimanë stereotipizohen si anakronikë. (Këtë më mirë se unë e ka sqaruar në një shkrim të tij të mëhershëm gazetari Ermal Mulosmani.

Të kthenemi tash te lista që Çani e kishte përgatitur për Ramën. Le ta quajmë këtë edhe si Lista e Qytetërimeve. Kadriinjë janë barbarët, ose plebenjtë, kurse jo-Kadriinjë janë qytetarët, ose patricët. Ironikisht këtë ndarje Rama është kujdesur ta bëjë edhe në mënyrë praktike gjeografike, përmes oligarkëve të tij. Kadriinjë, në kokën e Ramës, fillojnë aty ku e ka vënë traun

Shefqet Kastrati. Kadriinjë, për t'u futur në qytetërim i paguajnë oligarkut të Ramës nga 5 euro. Me shumë dëshirë Rama do ta bënte këtë 50 ose 500 euro. Ose edhe me më shumë dëshirë do ta bënte që të mos blihej fare hyrja në civilizim. Ose ke lindur, ose nuk ke lindur i qytetëruar. Mirëpo, djallëzia prapa kësaj ndarjeje që e bën Rama është politike. Të gjitha ata intelektualë, gazetarë, njerëz të pavarur, që janë kundër konceptit të Rilindjes së Ramës, prej këtij të fundit diskualifikohen në mënyrë pezhorative me cilësorë të ndry-

shëm. Ata fillimisht quheshin kazanë, kurse tash Rrotë Kadri, ose thjesht Kadri.

Emërues i përbashkët i jokadriinjve, ose atyre që Rama i konsideronte patricë, ishte të gjithë ata që punonin në "Top Channel", si Blushi, Eni etj., në të dy "Klanet", atë të Shqipërisë dhe të Kosovës, si Fevziu, Haxhiu (madje edhe Shkullaku e kaloi testin) dhe "Vizion Plus", si Balla. Këta ishin esnafët e gazetarisë shqiptare, ishin fisnikët që i japin vlerë të shtuar këtij profesioni, këta që punojnë në studio të mëdha dhe të bukura dhe që i kanë pronarë miqtë e Ramës. Kurse Kadriinjë ishin njerëzit e portave, ata që punojnë skutave dhe birave, që nuk e dinë ku i kanë zyrtar, që nuk financohen nga bizneset e ndërtimit të rrugëve. Këta mundësisht duhet të jenë veriorë, mundësisht të lidhur me Berishën, mundësisht me emra të vjetër, me emra të cilët mund të rimosh dhe tallesh me ta. Prandaj Rama bënte, ç'bënte dhe përpjeq që Artur Zhejin ta vendoste në anën e Kadriinjve, sikurse edhe Andi Bejten.

Në këtë shoqërinë e shtresës së muzikëve, Rama dukej qartazi që më së shumti ishte i mllësosur me Fatos Lubonjën dhe Andi Bushatin. Këta të dy, sipas logjikës së Ramës, do të duhej të zinin vend në pjesën gjeografike poshtë traun të Shefqet Kastratit. Lubonja dhe Bushati, edhe nisur nga emrat, edhe nga mbiemrat, e edhe nga ajo çfarë përfaqësojnë, sipas logjikës së Ramës do të duhej të ishin tek aristokracia e gazetarisë. Këta të dy ia prisnin Ramës matematikën. E kaluara e tyre nuk është berishiste. Ata kanë bërë më shumë sesa Rama për ta larguar Berishën nga pushteti dhe nuk mund t'i etiketojë si militantë të verbër të PD-së. E çka është edhe më e rëndë, për Ramën, nuk janë veriorë. Kjo shkon kundër rregullave dhe stereotipizimeve të tij. Ata Rama do të kishin dëshirë t'i rreshtonte në një vijë me aristokratët e "Topit", "Klanit" dhe "Vizionit", që të mbetej ballë për ballë me Çim Pekën, Fahri Kadri Balliun, ose Balli Kadri Fahriun, ose Kadri Fahri Balliun. Prandaj Rama u tërbua kur i dolën në ekran fotografitë e Lubonjës dhe Bushatit. Këta të dy kryeministri i Shqipërisë i konsideron tradhtarë dhe dezertorë në betejën e tij kundër prapambeturisë. Janë delja e tij e zezë.

Kurse unë, në mënyrë meritore gjendesha te kampi i Kadriinjve. Mjaftonte që Kosova e kishte një përfaqësues në "business class", Batonin, që është me prejardhje nga gjentilët e Drenicës.

Për lexuesit nga Kosova duhet ta sqaroj se kryeministri shqiptar, Edi Rama, i ka kategorizuar shqiptarët në Kadriinj dhe jo-Kadriinj. Kadriinj në librat e Ramës është një person i pagdhundur, malok, i keq, i parruar, i pambajtur, i paveshur dhe çdo gjë tjetër që e ka një "pa" përpara. Pse Rama e ka zgjedhur për protagonist Kadriun, e jo ta zëmë Stefanin, a Dhimitrin, kjo është një mesele në vetvete. Kadri është një emër mysliman, që gjendet kryesisht në pjesën verilindore të Shqipërisë, e posaçërisht edhe në Kosovë. Madje, në Kosovë është edhe një Kadri mjaft i njohur kryetar i Kuvendit. Madje, protagonistin fillestar i Ramës quhej saktësisht Kadri Veseli, ashtu sikur edhe quhet kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Opinion *i* Ditës

Trekëndëshi i së keqes, si mund të prishet

Nga Roni Telegrafi

(vijon nga faqja 1)

... që klasa politike dhe gjyqësori mbajnë mbi supë mëkate të rënda për nivelin e abuzimit dhe korrupsionit.

Por, a janë ata të vetmit që mbajnë përgjegjësi?

Mendoj se vëmendjes së opinionit publik i ka shpëtuar një klasë po aq e rëndësishme dhe përgjegjëse sa dy të parat. Është një klasë që nuk ka kryetar, nuk garon në zgjedhje, nuk shfaqet shumë në media dhe nuk ka parti.

Ajo është klasa administrative. Më konkretisht, klasa e hajdutëve të dobishëm në administratën publike.

Ekzistencën e kësaj klase e pranoi vetë kryeministri Rama kur në asamblenë e Partisë Socialiste, gjatë emërimit të z. Braçe, tha: "Eri- oni si zëvendëskryeministër do të ketë të gjithë autoritetin... për të dhënë kontributin e tij, besoj unikal, në pastrimin e administratës nga hajdutët, nga parazitët, dhe nga gjithfarëloj fundërrinash".

Duhet thënë se pas afro gjashtë vitesh në detyrë, kryeministri ka pasur mjaftueshëm kohë për ta pastruar administratën nga hajdutët. Përse nuk e ka bërë, e di ai.

Gjithsesi, nëse sot politika përfytyrohet si timoni që drejton makinerinë korruptive, atëherë administrata duhet përfytyruar si motori që gjeneron lëvizjen. Pa bashkëpunimin e administratës, aferat korruptive kurrë nuk mund të materializohen.

Për të vënë në lëvizje in-granazhet korruptive nevojiten një seri e tërë firmosjesh administrative. Politika gjithmonë firmos e fundit, në mos fare.

Administrata publike është sot po aq përgjegjëse për dëmin e keqeverisjes sa vetë politika dhe gjyqësori. Një pjesë e këtij dëmi është i dukshëm dhe i mirëdokumentuar.

Sipas raportit të fundit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dëmi shkaktuar buxhetit nga administrata publike për vitet 2015-2017 është 957 milionë euro. Tejet i lartë për një vend të varfër si Shqipëria.

Shpjegimi akademik i procesit qeverisës në demokraci mbështetet mbi teorinë e "Trekëndëshit të Hekurt". Sipas teorisë, politikat e një vendi demokratik janë produkt i sinergjive pozitive, që çlirohen nga marrëdhënie trekëndore ndërmjet grupeve të interesit, të zgjedhurve politikë dhe administratës.

Kjo teori shpjegon edhe procesin që prodhon dhe mbarështron korrupsionin. Si rrjedhojë, mund të thuhet se korrupsioni në Shqipëri është produkt i sinergjive kriminale, që burojnë nga një mar-



rëdhënie trekëndore ndërmjet gjyqësorit, politikës dhe administratës.

Por, cili ka qenë procesi që e transformoi një pjesë të administratës në një nga brinjët e "trekëndëshit të së keqes"? Pas rënies së komunizmit e deri më sot, ky proces ka kaluar në disa etapa.

Me ardhjen në pushtet, partitë mbushin administratën me militantë shërbëtorë. Me këtë, politika vret dy zogj me një gur. Shpërblen militantët me punësim dhe njëkohësisht plotëson makinerinë korruptive me njerëz të besuar që e vënë në lëvizje.

Në këtë periudhë të parë, rotacionet politike shoqërohen me spastrime të thella të administratës nga militantët të partive kundërshtarë. Duke qenë se punonjësit e administratës nuk janë shumë të mbrojtur ligjërisht, spastrimet kryhen lehtë.

Pas kësaj vjen etapa e shkëputjes politike, e cila përkon me ngjizjen e klasës së hajdutëve të dobishëm në administratë.

Kjo etapë është rezultat i rotacioneve politike. Partia e sapoardhur në pushtet spikat punonjësit administrativë që e kanë perfek-

sionuar artin e hajdutërisë, por që i përkasin partisë opozitare. Këta janë hajdutët e dobishëm, të cilët nëse pranojnë t'i shërbejnë pushtetit të ri, nuk preken nga spastrimet.

Kështu, rotacion pas rotacioni fillon e mbushen ngadalë radhët e klasës së hajdutëve të dobishëm, të cilët shkëpusin lidhjet politike me partinë që i ka punësuar fillimisht dhe i shërbejnë pushtetit të radhës.

Etapa e mëvonshme është ajo e partneritetit, e cila vjen si pasojë e pasurimit të hajdutëve të dobishëm. Duke qenë hallkë e rëndësishme e zinxhirit korruptiv, përfitimet financiare sa vijnë e stohohen.

Ata i kuptojnë mirë rregullat e lojës, ku më i rëndësishmi është se në demokraci, politika ka gjithmonë nevojë për para. He-dhin para në fushatë dhe dalëngadalë krijojnë një marrëdhënie partneriteti me politikën. Më të suksesshmit arrijnë të ngjisin shkallë të hierarkisë partiake dhe i paraqiten shoqërisë si figura politike.

Ky ka qenë rrugëtimi transformues i një pjesë të administratës

publike në 27 vitet e fundit.

Ndërkohë, vetingu në gjyqësor po sjell rënien e një brinje të trekëndëshit. Rënia e gjyqësorit pritet të sjellë një etapë të re transformuese për administratën. Etapën e tradhtisë ndaj politikës.

Për Italinë, 17 shkurti i vitit 1994 ish një ditë e parëndësishme. Në fakt, kjo do të ish dita e nisjes së një zinxhiri arrestimesh, që do të shfaqin para publikut Tanxhentopolin. Do të nisë ngritjen e një republike të re dhe rënien e një klase të tërë politike.

Më 17 shkurt arrestohet me zarf në dorë hajduti i dobishëm në administratën italiane, Mario Kiesa. Në qelitë e paraburgimit Kiesa pret ndihmën e politikës për të cilën punon. Ndiha nuk i vjen. Kur kupton se politika e ka tradhtuar, vendos ta tradhtojë dhe ai atë duke bashkëpunuar me drejtësinë. Tradhtia e Kiesës nis ortekun që sjell procesin 'Mani Pulite', i cili finalizohet me arratinë e turpshme në Tunizi të kryeministrit Kraksia.

Ndryshe nga ajo italiane, drejtësia e re shqiptare nuk do të ketë nevojë të arrestojë askënd në flagrancë. Për të nisur ortekun, ajo mjafton të hapë raportet e KLSH-së dhe aty do të gjejë të rreshtuar emrat dhe shkëlqet e hajdutëve të dobishëm që nxinin në vite faqet voluminoze. Më pas, nisja e etapës së tradhtisë është thjesht çështje kohe.

*** Autori ka shërbyer si zvmnistër i Buqësisë në kabinetin "Rama 1".**

HOROSKOPI

DASHI

Ekziston një rregull shumë i thjeshtë që duhet të ndiqni sot: pyesni për diçka dhe do ta merrni. Kjo përfshin vëmendjen e njerëzve, të cilët ju mund të mendoni se janë shumë të zënë ose shumë të rëndësishëm për të pasur kohë për ju.

DEMI

Disa nga situatat e reja ku do ta gjeni veten ditën e sotme do të jenë emocionuese dhe disa do të jenë të vështira. Mund ndodhëni në një mjedis të panjohur. Nuk ka nevojë të jeni vetëvetëdijshëm, sepse jeni midis njerëzve që ju respektojnë.

BINJAKET

Vetëm për shkak se dikush ka më shumë përvojë ose më shumë arsim se ju nuk do të thotë se ajo ose ai është më i mençur. Pra, mos kini frikë të shprehni mendimin tuaj sot, edhe nëse nuk i keni mendimet e organizuara me kujdes.

GAFORJA

A po përpiqesh të bindësh dikë që të pajtohet me ty? Sot është koha për një taktikë të ndryshme. Përdorni fuqinë e logjikës, në vend që të përpiqeni të tërhiqni zemrën. Empatia nuk është e lehtë për të gjithë.

LUANI

Koha është elementi më i rëndësishëm i ditës suaj. Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet tuaja, duhet të kaloni më shumë kohë me dikë që nuk e keni parë për një kohë të gjatë. Për të kursyer kohë, mos e humbini atë me njerëz që nuk e meritojnë vëmendjen tuaj.

VIRGJERESHA

Ekspërimentimi me pamjen tuaj është një mënyrë e mrekullueshme për të qëndruar në modë. Kjo do t'ju ndihmojë të dilni nga turma në një mënyrë të paharueshme. Ju e dini atë që duket e mirë për ju, kështu që investoni në diçka që tregon anën tuaj aventurose.

PESHORJA

Anëtarët e rrethit tuaj të brendshëm shoqëror kanë dëshirë që të planifikojnë një kohë të këndshme me ju, prandaj përpuni të bëni më shumë. Kthehu në kontakt me njerëzit dhe thoni "po" për çdo ftesë që ju dërgojnë. Nëse vepro- ni, do të argëtoheni.

AKREPI

Ambienti juaj ka një ndikim më të madh mbi ju sesa mund ta kuptoni, sidomos tani, kur ka kaq shumë lëvizje në jetën tuaj. Ju duhet të keni një strehë të sigurt ku mund të relaksoheni.

SHIGJETARI

Mos qëndroni në heshtje kur jeni i rrethuar nga njerëz që nuk i njihni. Jini të parët për të thënë diçka dhe mos u trembni nga të qenit i singërt. Është një ditë e mrekullueshme për të folur me njerëz që nuk i keni takuar kurrë më parë.

BRICJAPI

Gjërat e reja janë të papërmblajshme, por duhet të jeni të kujdesshëm për të mos u përfshirë në diçka thjesht sepse është e re. Prisi derisa të jeni të sigurt se është e vlefshme para se të përfshihen në një aventura.

UJORI

Tani nuk është koha për modesti të rreme. Nëse e dini që keni bërë diçka të veçantë pranoni. Keni frikë se mund të dukeni menjëherë? Njerëzit në jetën tuaj e dinë atë që keni arritur dhe do t'ju respektojnë më shumë nëse jeni krenar.

PESHQIT

Vetëm ju e dini nëse diçka nuk mund të bëhet në jetën tuaj - kështu që mos lejoni asnjëri të thotë se ju nuk keni mundësi. Qëndroni i fokusuar në gjërat që bëni dhe do të shihni se suksesi nuk do të mungojë.

MBROJTËSI I SKËNDERBEUT

Etashmja, por edhe e ardhmja, Fidan Aliti zbulon gjithçka në një intervistë për "Supersport", nga kompleksi "Tropikal", aty ku Skënderbeu po vazhdon minifazën përgatitore të dimrit. Në këtë periudhë merkatoje, ai është një nga emrat më të lakuar për vetë faktin pasi në drejtim të



Aliti: Jam gati për një aventurë në një klub të madh

qendërmbrojtësit që është një titullar fiks edhe te përfaqësuesja e Kosovës kanë mbërritur shumë oferta. Aliti e pranon se do t'i pëlqente një aventurë jashtë Shqipërisë, pasi është në moshën e duhur për ta bërë një hap të tillë. Në Suedi apo në një shtet

tjetër, kjo është në dorë të Skënderbeut që synon të përfillojë sa më shumë nga kartoni i tij. "Kemi pasur një stërvitje intensive javën e shkuar, por tashmë po luajmë edhe miqësore. Ka edhe dëmtime brenda grupit dhe na vjen shumë keq, sepse është dëmtuar

Bregu, i uroj që të rikthehet sa më shpejt. Kështu e ka futbollin, kjo është pjesë e kësaj loje. Ofertat? Deri tani jam në kontratë me Skënderbeun dhe jam i përqendruar këtu. Çdo lojtar e ka ëndrrën që të luajë jashtë dhe për mua që jam në kulmin e karrierës, do të ishte më mirë një aventurë në një klub të madh. Nuk e di në Suedi, apo diku tjetër..."

HABIT XHERDANI

Shaqiri: Tek Interi më çuan te një magjistar për kurim!

Xherdan Shaqiri, lojtari me origjinë shqiptare që përfaqëson Zvicrën, po kalon një nga formë mjaft të mirë në karrierën e tij me skuadrën e Liverpoolit. Mesfushori nga Gjilani shpeshherë me lojën dhe golat e shënuar ka arritur që të jetë protagonist për skuadrën e Jyrgen Klop. Ai ka folur për aventurën e tij me skuadrën e Interit, nga e cila nuk ka ngelur edhe shumë i kënaqur. 27-vjeçari ka rrëfyer për "SportBible" një moment kur ai ishte i dëmtuar gjatë kohës që luante me zikaltrit dhe ata i thanë se ishte një kurues në mal, që mund ta shëronte që ai të ishte pjesë e ndeshjes së ardhshme. "Një ditë isha i dëmtuar, por duhet të rikuperohesha për të luajtur në ndeshjen tjetër. Tek Interi më thanë se ishte një magjistar, një kurues që jetonte në mal. Bëhej fjalë për në person i moshës së tretë, si cili kishte aftësinë të shëronte. Mora makinën, udhëtova 1 orë e gjysmë dhe ai më kuroi, por asgjë nuk më bëri, isha si më parë. Në Angli është ndryshe, je i dëmtuar, ke problem, ke 7 fizioterapistë që të qëndrojnë mbi kokë, të ndjekin hap pas hapi deri sa të shërohen. Profesionalizmi vjen para së gjithash", - u shpreh Shaqiri.

Bregdetarët janë aktivë në merkato. Bullgari Vasiliev duket pranë firmës, por priten edhe elementë të tjerë



Jeton Selimi

Shkëmbi: Firmos për vendin e tretë, por..

Trajneri i Teutës nuk i vendos vetes limite këtë sezon

Bledi Shkëmbi është gati t'u dhurojë një sezon të paharruar tifozëve durrsakë, të cilët presin një titull kampion që nga viti i largët 1995. Teuta e atëherëshme ishte një skuadër e fortë dhe nën drejtimin e Hasan Likës, mundi të shpallet kampione. Më pas, shumë vite me më shumë ulje sesa ngritje, por gjërat tani duket se kanë ndryshuar. Bregdetarët janë në 'valle' për titull dhe trajneri korçar nuk kërkon që t'i vendosë limite vetes. Aktualisht skuadra është duke zhvilluar fazën përgatitore dhe grupi i lojtarëve është i plotë, pasi deri më tani askush nuk ka vuajtur dëmtime fizike. "Çdo gjë po shkon mirë, është më e rëndësishme në këtë fazë përgatitore që nuk kemi lëndime. Të gjithë futbollistët po marrin ngarkesën e duhur fizike", deklaroi trajneri Shkëmbi për "Supersport". Drejtuesit e "djemve të detit" janë aktivë në merkato. Pasi kanë arritur të shesin sulmuesin Amadu Latif



për 150 mijë euro në Bjellorusi, tashmë janë vënë në kërkim të një sulmuesi për ta zëvendësuar afrikanin. Teuta është një skuadër që prodhon raste goli dhe Shkëmbi ka nevojë për një sulmues që të njohë portën, ndaj kandidatura e bullgarit Vasiliev duket e përshtatshme. Gjithsesi, trajneri nuk jep emra, po as nuk i vë vetes limite, teksa thotë se pret më shumë se një sulmues në këtë merkato dimërore. "Nuk do të ishte korrekte nëse do të përmendja emra. E rëndësishme është që sa më shpejt të mbyllem një sulmues, ndoshta edhe dy, për të qenë gati për kampionatit. Mund të ketë përforcime edhe në ndonjë repart tjetër, sigurisht nëse do

të ketë cilësitë e duhura". Sezioni i Teutës është vërtet i jashtëzakonshëm. Hera e fundit që durrsakët kanë qenë pretendentë ndodhte në sezonin 2011-2012 dhe në ndeshjet e fundit të sezonit u desh t'i dorëzohen Skënderbeut. Kështu, duke parë historinë e afërt, Shkëmbi deklaron me modestë se do të ishte i kënaqur edhe me vendin e tretë, por natyrisht që nuk mund ta mohojë se kur mungojnë dhe 18 ndeshje nga fundi i kampionatit, gjërat mund të ndryshojnë. "Patjetër që do të firmosja, por e di shumë mirë, ndoshta si futbollist dhe jo si trajner, që llogaritë bëhen në fund, jo pas dy fazave. Kemi bërë diçka të mirë deri tani", përfundon trajneri i Teutës, Bledi Shkëmbi.

SITUATA

Ramsej vjen që në janar, nëse Benatia kalon tek Arsenal

Juventusi dhe Aron Ramsej e kanë arritur marrëveshjen mes tyre, por mund të gjendet edhe një "çelës" në marrëveshjen e bardhezinjve me Arsenalin, për të përshpejtuar ardhjen e uellsianit në Torino që në janar. Bëhet fjalë për Medi Benatia, mbrojtësi i cili për momentin është i dëmtuar, mund të jetë një zgjedhje e dobishme për formacionin e Unai Emeri. Marokeni pësoi një dëmtim para nisjes së ndeshjes së djeshme ndaj Bolonjës dhe do i duhet të humbasë edhe finalen e Superkupës ndaj Milanit. Benatia e ka bërë të qartë që nuk është i kënaqur me minutat e dhëna nga Alegri dhe një ofertë e mirë do sillte edhe largimin e tij drejt Londrës, që nga ana tjetër do përshpejtoje edhe ardhjen e Ramseit që në janar.



SITUATA TE PARTIZANI

Rama i ofron rinovimin, Gega vendos kushte


Prej dy ditësh, pranë skuadrës në Antalia ka shkuar edhe drejtori i përgjithshëm i Partizanit, Olsi Rama. Nga sa mësohet, ky i fundit ka biseduar me trajnerin Gega edhe për rinovimin e kontratës. Siç dihet, kreu i pankinës së kuqe kishte firmosur për 6 muaj me të drejtë rinovimi, ndërsa pas përfundimit të pjesës së parë të sezonit, ku Partizani u shpall kampion dimri, drejtori deklaroi publikisht se Gegës do t'i vendosej një letër e bardhë për të zgjidhur marrëveshjen. Mësohet se trajneri ka paraqitur një projekt për vazhdimësinë, që tashmë duhet të gjejë mbështetjen e klubit. Por palët në këtë moment po diskutojnë njëkohësisht edhe për merkaton, teksa Rama ka siguruar Gegën se do të afrohen ata lojtarë që ka kërkuar. I pari që duket se ka kënaqur trajnerin është afrimi i qendërmbrojtësit kosovar, Lum Rexhepi, i cili pritet të prezantohet zyrtarisht këto ditë.



Beshiktashi i jep 400 mijë euro Atalantës për Gjimshitin

Transferimi i Berat Gjimshitit në radhët e Beshiktashit duket se është një mundësi reale dhe jo thjesht një thashethem i merkatos. Klubi turk dhe Atalanata kanë nisur negociatat për transferimin e lojtarit, pasi të gjitha palët e përfshira në këtë çështje duket se kanë dhënë pëlqimin e tyre për realizimin e marrëveshjes, thjesht po diskutohen detajet financiare, të cilat për momentin mbajnë peng gjithçka. Mediat turke kanë bërë të ditur se trajneri i Beshiktashit, Senjol Gynesh, ka vlerësuar pozitivisht mbrojtësin shqiptar dhe u ka bërë të ditur drejtuesve të klubit se bëhet fjalë për një zgjidhje shumë efektive, pasi është një qendërmbrojtës i cili luan mirë edhe me të majtën. Për këtë arsye, ai që në fillim ishte propozimi i menaxherit të Gjimshitit, është kthyer në bisedë konkrete transferimi. Beshiktash ka kontaktuar Atalantën, me të cilën lojtari ka një kontratë deri në mbyllje të këtij sezoni. Në fakt, presidenti i klubit i kishte bërë të ditur Gjimshitit se ishte gati t'i rinovonte edhe një vit kontratën, por nuk ka asgjë të zezë mbi të bardhë, ndaj lojtari mund të negociojë lirish me klube të tjera. Në këtë situatë, Atalanta i ka kërkuar Beshiktashit 400 mijë euro për transferimin e futbollistit, por klubi turk kërkon që ta ulë këtë shifër, duke paralajmëruar italianët se nëse gjen akordin me lojtarin, mund ta transferojë falas në fund të sezonit. Në këtë situatë, negociatat mes palëve vazhdojnë dhe sipas shtypit turk nuk është çudi që transferimi të realizohet që javën e ardhshme, nëse mes tyre gjendet gjuha e përbashkët.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- O Toole aktor
- Si vizuale.
- Në fund të lutjes.
- Janë popullsi e qytetit
- Një pije freskuese.
- Është enjite.
- Teke prize.
- Janë mallkime shkishëruese.
- Një afësi paranormale.
- Janë fakultetet më me leverdi.
- Gjëja e romakëve.
- Thahen me bonifikim.
- Zemecisk regjisor
- Janë në temë
- Inicialet e Harris aktor.
- Është figurë gjeometrike.
- Një markë makine qepëse.
- Kush ka... ka zët.
- Mbyllin komentin.

- I bëhen të gjitha mikut.
- Një version i dikurshëm i FIAT.
- Fillojnë shkurt.
- Një pikë në ligji.
- Inicialet e Morricone-s.
- Të fundit në manastir.
- I ka kërcyer të xhindosurit.
- Janë pjesë të dramës

VERTIKAL

- Fillojnë panikon.
- Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
- Në krye të tenorëve.
- Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
- Inicialet e Anka këngëtar.
- Kush ka... ka nevojë për gjak
- Ndiqet ajo e fundit
- Duken të gjata në pritje.
- Një fazë gjumi.
- Shteti i francezëve
- Një art i shtatë.
- Është pellgu.
- Shkroi Pa familje
- Janë dokumente shtëpie.
- Është filmi që mallëngjen.
- Një koleg anglez.
- Janë baballarët.
- Mund të jetë elektrike.
- Është hidrofobi.
- Ajo e forcës është për të çmendur.
- Kremi pa ekstreme.
- Si sezonale.
- Mund të jenë unike
- Mund të jenë periodike të tilla.
- Është bishë që zgërdihet.
- Fillojnë nazet
- Inicialet e Diamanti aktore.
- Është moshë më e bukur.
- Fillojnë temën.
- Kufizojnë një send.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një film publicitar
- Në krye të bashkisë
- Në Romeo në makinë
- Në fund majtas
- Janë kompozime si Vejusha gazmore
- Janë në masë.
- Janë melodrama.
- Fillojnë dobët.
- Në hyrje të radios.
- Një pjesë e lipotimisë.
- Është gjendje të fikti.
- Është vërtet i mërzitshëm.
- Maiden që këndojnë
- Hurley aktore.
- Pak torturuese.
- Ekstreme në tunel.
- Ndezur në aparaturë.
- Ai i shenjtë është papa.
- Merrte fuqi nga toka.
- Pak enigmatike.

VERTIKAL

- Ngryset në mbërmeje.
- Kufij itinerari.
- Ai i harrësës ishte Leti.
- Është porosia e fundit.
- Janë bimë uji.
- Opera e Mascagni-t.
- Magritte piktor.
- Është ndenjësë zbukurimi.
- Ndiqen me ilaçe.
- Në krye të armiqve.
- Një godinë në miniaturë
- Është muzika... më e kollajtë.


VERTIKAL

- Qe mbreti i parë i Izraelit.
- Post scriptum
- Një sferë... për model.
- Është infeksion në bark




- Një mund të jetë arme.
- Në krye të atletëve.
- Është grimcë me bërthamë.
- Është sundimtar si Tutankamon
- Masat pa Kufij
- Një sport baskësh
- Janë marrëdhënie.
- Padia pa kufij.
- Është në minorancë.
- I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
- Kështu janë lojtarë te formaconit
- Janë të holla dhe therëse.
- Makinë ruse.
- Është dita e dytë
- Bisha aktore.
- Në mes të rrugës.
- Një trup pa kënde.
- Satie kompozitor.
- I ka të ndryshme një sakat.
- King Cole i muzikës.
- Inicialet e Penn aktor.
- Në mes të dhomës.
- Të fundit në spital.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	8			4	3			
9			2	4	5	6		
	1					8	9	
		5	7	9	4			
			6	8		5	7	
1		2						
	3	4	9				8	
6	9	7						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	5	8	4	1	6	3	9	7
6	4	9	7	5	3	2	8	1
7	3	1	9	8	2	6	4	5
5	1	2	3	6	9	4	7	8
9	8	3	5	4	7	1	2	6
4	7	6	8	2	1	9	5	3
3	6	4	2	7	8	5	1	9
1	2	7	6	9	5	8	3	4
8	9	5	1	3	4	7	6	2

Argëtim filozofik

- Gratë e bukura kurrë nuk dyshojnë në inteligjencën e vet, por gratë inteligjente çdoherë dyshojnë në bukurinë e vet.

- Disa meshkuj kanë atë që e kanë merituar, të tjerët janë të pamartuarit.

- Njeriu i vërtetë mbetet i zakonshëm, plotësisht i zakonshëm. Askush nuk e di kush është, askush nuk e di se çfarë thesari ai mban brenda tij. Ai kurrë nuk reklamon, kurrë nuk përpiqet të shfaqet. Por në pse reklamojmë? Për shkak të "ego". Nuk jeni të kënaqur me veten. Ju jeni të kënaqur vetëm kur të tjerët ju vlerësojnë.

Thënie të mençura

- "Respektimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë janë themelet e harmonisë familjare"
- "Nuk keni dashuruar kurrë sepse nuk keni mësuar kurrë të jepni, jepni dhe jepni. Momenti që mendoni, çfarë marr si këmbim, dashuria bëhet një transaksion".

- Një gënjeshtër në momentin e duhur është 100%
- herë më e mirë se sa një e vërtetë në momentin e gabuar.
- Nuk me vjen inat që më gënjen, por më vjen inat përse mendoni që besoj në ju.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

15D	1	7	2	3	1	4	2	17	6	2	4	T	R	I	M	S	M	M	A	S	A	T	
6O	2	3	10		11		17	4	9	3	2	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A		
17B	7	8	6	9	6	13	4	6		17	7	K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L	
7I	11	7	2	6	1	4	2		2	4	8	M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E	
8	6	12	4	13	2	4	2		4	9	4	K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	
18	3	1	4	12		4	1	4		1	3	2	O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	
2	3	12	2	3	12		3		16	1	3	3	M	N	I	E	N	O	G	F	T		
16	3			4	15		16	2	7			P	S	N	N	I	M	A	L	L	I		
15	2	4	8	16	2		12	7	2	4	2	A	M	I	A	N	T	K	O	S	E		
4	18		1	1	7		8	7	9	6	13	7	N	O	T	E	K	I	P	O	R	E	
12	7	1	7	3	12		8	1	4	1	4	2	I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	
7	2	3		10	7	3		3	2	7	6	A	L	I	B	I	S	I	R	T	A	R	I

